



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Marketing”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Ismail Qemali”
Vlorë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof As. Arlinda Ymeraj

2. Dr. Ana Buhajjoti

Prill/2020

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në Marketing ofrohet nga Departamenti i Biznesit të Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Institucioni i Arsimit të Lartë, publik, "Universiteti i Vlorës" është krijuar me vendim Nr. 105, datë 28.02.1994 me propozim të Ministrisë së Arsimit, Këshillit të Ministrave, me emërtimin "Universiteti i Vlorës" dhe është riorganizuar me vendim Nr. 822, datë 05.12.2007 me emërtimin Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë. Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 71, datë 21.09.2017 për akreditimin institucional të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me kohëzgjatje 3 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 30.09.2020. Aktet rregullatore të IAL-së, Statuti e Rregulloret e Institucionit janë rishikuar në përputhje me ligjin për arsimin e Lartë dhe aktet normative në fuqi, siç janë konstatuar dhe nga GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave në IAL. Institucioni ka përgatitur një Plan Strategjik i cili është i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të programit të studimit si dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë përbëhet nga 4 njësi kryesore:

- Fakulteti i Ekonomisë
- Fakulteti i Shkencave Humane
- Fakulteti i Shëndetit
- Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore

Programi i studimit Bachelor në "Marketing" ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë. Ky fakultet përbëhet nga:

- Departamenti i Biznesit
- Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit
- Departamenti i Ekonomiksit
- Qendra e Kërkimit Shkencor e Fakultetit të Ekonomisë

Programi i studimit Bachelor në Marketing, pjesë e Departamentit të Biznesit, është hapur me VKM Nr. 270, datë 10.06.2011. Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (UMASH). Programi i ciklit të parë ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe dhe kohëzgjatja e tij është 3 vite akademike, me 180 ECTS. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në "Marketing" e regjistruar me Vendim Nr. 439, datë 09.09.2011 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Programi ka pësuar ndryshime me Vendim Senati Nr. 58, datë 06.09.2018 në masën 20% në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Këto ndryshime janë miratuar edhe nga MASR me shkresë Nr. 10761/1, datë 25.10.2018. Programi i studimit nuk ka kaluar më parë proces akreditimi.

Ky program studimi është hartuar në konsideratë të zhvillimeve social-ekonomike të vendit tonë si dhe një analize të tregut të punës. Siç paraqitet në dokumentat orientuese të IAL-së, programi synon t'u ofrojë studentëve njohuri të thelluara në marketing, si dhe pajisjen me instrumentat themelorë për rritjen e aftësive në marketing.

Programi i studimit Bachelor në Marketing plotëson në tërësi kriteret sa i takon rëndësisë së programit për nevojat e ekonomisë, rritjes së kërkesës për profesionistë marketing në fusha të ndryshme të aktiviteteve ekonomike, organizimit dhe administrimit me një staf të kualifikuar, mësimdhënies e mësimnxënies për realizimin me cilësi të programit të studimit.

GVJ kërkoi dhe aksesoi gjatë vizitës të dhënat lidhur me përbërjen e stafit, titujt akademikë dhe ngarkesën e personelit akademik. GVJ vlerëson se personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programit të studimit dhe të zhvillimit të institucionit. Institucioni zotëron të dhëna të sakta për veprimtarinë e kualifikimit të vazhdueshëm profesional.

Institucioni realizon vlerësim të programit të studimit nëpërmjet anketimit të studentëve. Vlerësimi zhvillohet gjithashtu nga drejtuesi i njësisë bazë, por edhe në nivel Fakulteti nëpërmjet shkëmbimit interaktiv me stafin dhe vlerësimeve në fund të vitit bazuar në veprimtarinë shkencore të personelit akademik, të cilat rezultojnë të dokumentuara në departamentin e Biznesit si njësi përgjegjëse e programit.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka siguruar një godinë të veçantë për Fakultetin e Ekonomisë me infrastrukturë të qëndrueshme për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe administrative, në funksion dhe të programit Bachelor në Marketing. *GVJ tërheq vëmendjen për përmirësimin e kushteve fizike të institucionit dhe pajisjen e auditoreve me ngrohje, dhe pajisje didaktike dixhitale si kompjuter e projektor. Gjithashtu, të shtohen laboratorët e kompjuterave për studentët pasi në nivel Fakulteti ofrohet vetëm një laborator me 25 poste. Mjediset në të cilat zhvillohet aktiviteti akademik kanë nevojë për përmirësim në mënyrë që aktiviteti akademik e shkencor të zhvillohet në standartin e nevojshëm.*

Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e Fakultetit të Ekonomisë dhe bibliotekën e Universitetit. *GVJ tërheq vëmendjen që të rinovohet literatura e bibliotekës me titujt bashkëkohorë dhe të rinovohet aksesit në revistat shkencore online, të cilat për momentin nuk ishin të aksesueshme.*

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Projekteve mat ecurinë e programit të studimit për qëllime përmirësimi duke përdorur një metodologji me instrumente matëse dhe vlerësuese si pyetësorët për studentët, raporte të njësive kryesore e njësive bazë, vlerësime për pedagogët nga Departamenti i Biznesit, por edhe Fakulteti. Njësia promovon aktivitetin e saj në një hapësirë të dedikuar në faqen web të Universitetit dhe angazhohet në forcimin e imazhit të Universitetit dhe ndërkombetarizimin e tij, për të cilën ka marrë dhe vlerësimin “Erasmus Best Practise”.

Pranimi i studentëve në këtë program studimi është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe Statutit të Universitetit “Ismail Qemali” dhe Rregullores së Programit.

Në regjistrin e administruar nga sekretaria mësimore e institucionit janë pasqyruar të dhënat e studentëve të regjistruar në këtë program studimi në përputhje me dokumentacionin që gjendet në dosjen e studentit, e cila u verifikua dhe me vizitën e GVJ bazuar në një përzgjedhje të rastësishme.

Institucioni mban të dhëna dhe kontakte me studentët e këtij programi përmes sistemit të komunikimit të brendshëm, ku çdo student ka hapësirë vetjake të dedikuar përmes të cilit

informohet e ka akses në dokumentacionin elektronik. GVJ konstatoi se përmes sektorit të Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës institucioni mban kontakte me studentët dhe pas përfundimit të studimeve. *GVJ rekomandon një transparencë më të madhe të institucionit në lidhje me punësimet e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi si dhe krijimin e mundësive të punësimit për studentët që frekuentojnë programin aktualisht.*

Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe vendase e të huaja me qëllim kualifikimin e mëtejshëm të stafit, tërheqjen e studentëve të huaj, ndërtimin e programeve të reja të studimit dhe ndërkombëtarizimin.

Programi i studimit Bachelor në Marketing mbështet profilizimin dhe zhvillimin e aftësive të specializuara të studentëve në Marketing. Kjo është një mundësi për lidhjen e studentëve me një sektor apo profesion që në ciklin e parë të studimit. Por nga ana tjetër paraqet një sfidë për realizimin e një formimi sa më profesional vetëm me një numër të kufizuar lëndësh dhe pa formimin në praktikë të studentëve në profilin Marketing. *GVJ rekomandon që njësisia përgjegjëse e programit të ndërmarrë një studim të thelluar tregu lidhur me prirjet dhe ndryshimet e shpejta në profilin Marketing në mënyrë që të përforcojë avantazhet e këtij programi në raport me programe të tjera Bachelor të ofruar në fushën e biznesit. Kjo kërkon dhe një gjurmim real të alumnit në tregun e punës, çka do të ndihmojë në nxitjen e kërkesës së ardhshme për këtë program.*

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në Marketing ka ndjekur hapat rigorozë të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procesi nisi me kontaktin me ekspertët, të cilët u trainuan për standartet e cilësisë dhe kriteret, si edhe mbi përdorimin e sistemit elektronik, në seksionin paneli i ekspertit. Në këtë fazë të parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës, i përbërë nga ekspertët dhe koordinatori Teknik i ASCAL. Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, u hartua axhenda e vizitës në institucion. Në fazën e dytë u zbatua me rigorozitet axhenda e takimeve në dy ditët e vizitës 27-28.02.2020. GVJ mblodhi informacion të nevojshme për një vlerësim rigoroz bazuar në takime me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjësen e Departamentit të Biznesit, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, sekretarinë mësimore, Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Edukimit, dhe Studentët e programit të studimit. Të gjitha informacionet e mbledhura nga takimet, u përdorën nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga Prof As. Arlinda Ymeraj dhe Dr. Ana Buhaljoti për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Gjatë të gjithë procesit ky grup pune u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, Z. Erjon Xhako.

Draft raporti i vlerësimit të jashtëm u dërgua në institucion me anë të sistemit AMS më datë 26.03.2020. Institucioni ka përcjellë komentet mbi draf raportin me anë të sistemit AMS më datë 02.04.2020. *Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me IAL, për dërgimin e draft raportit dhe raportit të vlerësimit të jashtëm është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 datë 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.*

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin (Komenti 1) që bëhet për rekomandimin e GVJ (fq 4) që njësia përgjegjëse e programit të ndërmarrë një studim të thelluar tregu lidhur me prirjet dhe ndryshimet e shpejta në profilin Marketing, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin, por vetëm arsyeton në përputhje me sugjerimin se një bashkëpunim më i konsoliduar njësi, student, institucion, sektor publik dhe privat duhet të bëhet për të përforcuar programin e studimit.
2. Lidhur me komentin (Komenti 2) që bëhet për standartin 1.3, kriteri 1, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport.** Në vlerësimin tonë mbetet me rëndësi që objektivat për programin e studimit bachelor në marketing duhet të jenë specifike dhe të qarta. GVB nuk sjell fakte të reja për të dalluar objektivat e këtij programi nga të programeve të tjera bachelor të njësisë.
3. Lidhur me komentin (Komenti 3) që bëhet për standartin 1.3 kriteri 3, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin, por vetëm jep arsytet në mbështetje të lëndëve të prëfshira në programin bachelor si edhe të integritetit të praktikës mësimore në semestrin e fundit me qëllim




aftësimin e studentëve në tregun e punës. Gjithashtu vetë GVB gjykon që njësia duhet të ndërmarrë një studim drejtuar studentëve bachelor dhe master që ndjekin një program studimi në marketing mbi integrimin e praktikës në bachelor.

4. Lidhur me komentin (Komenti 4 dhe komenti 5) që bëhet për standartin 1.5 kriteri 3, GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep fakte dhe as evidenca konkrete që kundërshtojnë vlerësimin, dhe GVB bie dakord me sugjerimin e GVJ. Edhe pse nënvizohet aktiviteti i zyrës së Karrierës, mungojnë evidencat që të mbështesin efektivitetin e veprimtarisë së saj.
5. Lidhur me komentin e GVB mbi sugjerimin e GVJ në lidhje me zbatimin e standartit 2.1 kriteri 5 (Komenti 6), GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport** në përputhje me evidencën e GVB-së se lëndët “Sjellje Organizative” dhe “Menaxhim i Burimeve Njerëzore” janë gjykuar nga departamenti në planin mësimor të marketingut duke i përfshirë në grupin e lëndëve plotësuese. Komenti ndryshon në “GVJ gjykon që Departamenti diskuton dhe vendos mbi pozicionimin e lëndëve “Menaxhim i Burimeve Njerëzore” dhe “Sjellje Organizative”.
6. Lidhur me komentin mbi zbatimin e standartit 2.1, kriteri 6 (Komenti 7), GVJ gjykon që **nuk ka ndryshim në raport** pasi numri i studentëve të regjistruar nuk mund të jetë rrjedhojë vetëm e ndryshimit të programit, përveç faktit që ky ndryshim nuk ka ndjekur gjithmonë të njëjtin kah.
7. Lidhur me komentin mbi përfshirjen e praktikave (Komenti 8), GVJ gjykon që **nuk ka ndryshim në raport**, pasi argumentimi i GVB se studentët e bachelor do të kenë mundësinë e realizimit të praktikës në Master Profesional, nuk është i mjaftueshëm, pasi një pjesë e studentëve mund edhe të mos regjistrohen në studimet e nivelit të dytë. Gjithashtu, praktika mësimore rezultojnë të jetë kërkesë edhe e studentëve.
8. Lidhur me komentin mbi zbatimin e standartit 2.4, kriteri 7 (Komenti 9), GVJ gjykon që **nuk ka ndryshim në raport**, sepse argumentimi i GVB mbi mbledhjen e të dhënave nëpërmjet pyetësorit të disponuar në web, nuk sjell evidencë mbi të dhënat dhe analizën e tyre në raport me punësimin e studentëve të UV.
https://docs.google.com/forms/d/1rQnjfSf5T5sca3V66XvTSromDgRGzdOV_Z9SKszliVk/edit#responses.
9. Lidhur me komentin që bëhet për standartin 3.4 kriteri 3 (Komenti 10), GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi rekomandimet e GVJ bazohen në inspektimin nga afër dhe njohjen me infrastrukturën e mësimdhënies. Sugjerimi i GVJ në këtë standard është në të mirë të procesit.
10. Lidhur me komentin që bëhet për standartin 3.6 kriteri 2 (Komenti 11), GVJ gjykon se **nuk ka ndryshim në raport** pasi komenti i GVB nuk jep fakte që kundërshtojnë vlerësimin, por vetëm jep arsytet se përse vlerësimi është ai i bërë nga GVJ.




11. Lidhur me komentin që bëhet për standartin 3.7 kriteri 2, (Komenti 12), GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport** në përputhje me evidencën e GVB-se të integritit të lëndës ndërdisiplore ‘Sjellje Organizative’ në program. Komenti ndryshon në “*GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rekomandon thellimin e kopetencave ndërdisiplinore në Sociologji, Psikologji të nevojshme dhe për profilizimin në marketing.*” GVB pranon sugjerimin pasi pohon se “*rekomandimi do të gjykohet në department*”.
12. Lidhur me komentin për mënyrën e zbatimit të standartit 4.1, kriteri 2(Komenti 13), GVJ gjykon **se nuk ka ndryshim në raport**, pasi komenti i GVB-së është vetëm shpjegues dhe nuk sjell të dhëna që kundërshtojnë vlerësimin.
13. Lidhur me komentin mbi Standartin 6.1 kriteri 2, (Komenti 14), GVJ gjykon se **ka ndryshim në raport**. Komenti ndryshon në “*Institucioni, me vendim të Senatit ka krijuar edhe Komisionet e Përhershme të Cilësisë në nivel institucioni dhe në nivel Njësie Kryesore (Fakulteti)*”.
14. Lidhur me komentin mbi Standartin 6.2, kriteri 5 (Komenti 15), GVJ gjykon **se nuk ka ndryshim në raport**, pasi komenti i GVB-së nuk sjell të dhëna mbi ndikimin e masave të marra mbi rritjen e cilësisë së mësimdhënies, por vetëm shpjegon masat e marra.

Së fundi vlen të theksojmë se bazuar në dokumentacion dhe vizita në institucion, GVJ ka bashkëvepruar për të ndërtuar një raport sa më realist dhe ndihmues për institucionin.




Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Marketing”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në Marketing i ofruar nga Departamenti i Biznesit në Fakultetin e Ekonomisë, në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë është në përputhje me Misionin dhe Qëllimet e Institucionit të shprehura në Statutin e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë (UV), (Statuti i UV-së, Neni 3, Neni 4) dhe Planin Strategjik të UV-së 2018-2024.</p> <p>Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimeve ekonomike e sociale të vendit. Ai i paraprin sfidave të zhvillimit të politikave të Marketingut në vendin tone në mbështetje të interesave të industrisë dhe shoqërisë në tërësi. Bizneset dhe institucionet në vend kanë kërkesë në rritje për specialistë në fushën e marketingut, për të mbështetur funksionet e tyre dhe realizuar aktivitetin në treg. Kësaj prirje i përgjigjet UV me programin e studimit Bachelor në “Marketing” i cili mbështet profilizimin dhe zhvillimin e aftësive të specializuara të studentëve në disiplinën e Marketingut që në ciklin e parë të studimit. Duke vlerësuar se njohuritë në marketing sot janë kthyer në domosdoshmëri për të gjitha institucionet private dhe ato shtetërore, ky program përputhet me kërkesat kombëtare për ekspertë dhe specialistë të formuar në nivel cilësor në marketing. Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të UV-së u dallua se programi Bachelor në Marketing përbën risi në ofertën akademike dhe është në përputhje me kërkesat e tregut kombëtar të punës.</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Vizioni i UV-së e angazhon atë në shërbim të dijes, edukimit dhe mirëqënies së shoqërisë shqiptare duke u mbështetur në cilësinë e mësimdhënies, kërkimit profesional e integritet social. (Vizioni, Plani Strategjik 2018-2024). Në këtë kontekst vetë institucioni mbështet programin e studimit Bachelor në Marketing, me procese cilësore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me qëllim sigurimin e dijeve të qëndrueshme e bashkëkohore teorike e praktike, të cilat janë evidentuar edhe tek qëllimi i programit të studimit</p>




	<p>dhe bazuar në dokumenta strategjike të insitucionit. Këto të fundit shtojnë vlerë akademike e kulturore në krijimin e traditës së arsimit në këtë degë e fushë të dijes, e cila pas viteve '90 ka marrë vëmendje të rëndësishme për shoqërinë dhe ekonominë e vendit. UV me programin Bachelor në Marketing kërkon të përforcojë njohuritë dhe ekspertizën në fushën e marketingut duke u mbështetur në bashkëpunimet me institucionet publike, organizatat si dhe me aktorë lokalë e ndërkombëtar për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në funksion të zhvillimit kombëtar. Qëllimi final është të mësuarit më cilësor, i cili shprehet dhe në strategjinë e insitucionit. Këto ndikojnë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë në sistemin e mësimdhënies dhe përvetësimin e dijeve dhe ruajtjen e forcimin e mëtejshëm të vlerave akademike e kulturore të kombit.</p> <p>Gjithashtu, veprimtaria kërkimore-shkencore e UV-së zhvillohet në përputhje me nevojat ekonomike e sociale të vendit dhe synon tu paraprijë sfidave të zhvillimit dhe integritit të vendit në stukturat europiane, si p.sh zhvillimit të qëndrueshëm, zhvillimit të ofertës turistike, rritjes së konkurrencës.</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë në Shqipëri dhe me vlerat kulturore e kombëtare.</p> <p><i>(Statuti i UV-së); (Plani Strategjik 2018-2024)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e insitucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Tek misioni i UV vihet theksi tek elementi i cilësisë së edukimit, shërbimi i shoqërisë, kontributit në kërkim në të mirë të shkencës dhe tregut të punës. Në këtë kontekst duke krahasuar me elementët e programit Bachelor në Marketing, synon përgatitjen e specialistëve për punësim në sektorin publik dhe privat në fushën e marketingut duke siguruar njohuri të qëndrueshme në fushën e marketingut dhe ndikuar në zhvillimin e kapaciteteve të marketingut. Programi i studimit Bachelor në Marketing është në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të UV, dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në këtë fushë.</p> <p><i>(Statuti i UV-së); (Plani Strategjik 2018-2024); (Rregullore e UV-së)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Marketing reflekton misionin dhe objektivat për formimin e studentëve. Programi i studimit ka përmabajtje të tillë që tu ofrojë</p>




	<p>studentëve njohuritë bazë në marketing, për tu thelluar në mënyrë të njëpasnjëshme në ciklet e tjera të studimit.</p> <p>GVJ pas konsultimit të dokumentacionit bazë dhe vizitave në insitucion konstatoi se programi është hartuar në përputhje me zhvillimet në tregun e punës. Pas përfundimit të tij studentët kanë përfunduar njohuri se si menaxhohet një ndërmarrje apo biznes, duke u pajisur me shprehje të veçanta në marketing. Marketingu është një drejtim i kërkuar nga tregu i punës vendas, i cili po i shton vlerë arsimit profesional në vend përmes njohurive bashkëkohore dhe ndërkombëtare të ndërlidhura me përvojën shqiptare në funksionimin dhe menaxhimin e strukturave të specializuara në marketing.</p> <p><i>(Statuti i UV-së); (Plani Strategjik 2018-2024); (Rregullore e UV-së) (Plani mësimor Bachelor në Marketing)</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>UV ka hartuar dhe miratuar një Plan Strategjik për zhvillimin e institucionit, për periudhën 2018-2024.</p> <p>Pas shqyrtimit të planit strategjik, GVJ vlerëson se prioritetet strategjike janë cilësia dhe performanca akademike, kërkimi shkencor, bashkëpunimet brenda dhe jashtë vendit, të cilat krijojnë një mjedis që promovon të mësuarin interaktiv duke i shërbyer edhe dialogut konstruktiv në nivel institucioni, si dhe shërbimit publik në bashkëpunim me njësitë lokale e vendore për tu dhënë zgjidhje problemeve të ndryshme në përputhje me misionin e IAL-së. Pjesë e këtyre prioritetëve është përshtatja e vazhdueshme e kurrikulave dhe programeve me tregun e punës. Ndaj, vlen të theksohet se programi i studimit Bachelor në Marketing është në përputhje me Planin Strategjik të IAL-së. (Plani Strategjik 2018-2024). Ai është hartuar duke konsideruar sfidat e mëdha të mjedisit gjithmonë e më konkurrues, punëdhënësit si dhe shoqërinë në tërësi. Programi Bachelor në Marketing i përgjigjet sfidave dhe nevojave të tregut në funksion të zhvillimit ekonomik e social të vendit. Kurrikula është e specializuar për profilizimin e studentëve në disipilinën e</p>




	<p>marketingut dhe i përgatit ata për ciklet e tjera të studimeve. Plani strategjik, statuti, dhe rregullorja e IAL-së janë ngushtësisht të lidhura dhe të ndërvarura me njëra – tjetrën në kërkim të standarteve akademike e kërkimore, të kërkimit shkencor, mësimdhënies, vëmendjes ndaj studentëve, dhe mbështetjen për biznesin e nevojat e zhvillimit perspektiv të shoqërisë.</p> <p><i>(Plani Strategjik 2018-2024); (Statuti i UV-së); (Rregullore e UV-së)</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi Bachelor në Marketing është në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit në fuqi, duke ofruar një tërësi prej 30 lëndësh ku përfshihet dhe Punimi i diplomës/Provimi i formimit, me një total prej 180 kreditesh. Lëndët e profilit marketing janë 9 dhe përbëjnë 30% të lëndëve të programit, dhe zënë 60% të grup lëndëve karakterizuese. Këto elementë janë konceptuar për të formuar studentët në fushën e përzgjedhur të marketingut. Programi i studimit është bazuar në statutin, misionin dhe vizionin e UV. Drejtim prioritar i institucionit është rritja e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore të tregut të punës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. Në Statutin dhe Rregulloren e UV gjejmë të përcaktuar mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, dhe administrative. UV ka hartuar programin e studimit Bachelor në Marketing në koherencë me mënyrën e organizimit të institucionit, të njëjste kryesore dhe integrimin e lëndëve bazë brenda programit për të rritur eficientë institucionale. Statuti është dokumenti kryesor mbi të cilin zhvillohet e gjithë veprimtaria mësimore, shkencore dhe edukative në UV.</p> <p><i>(Statuti i UV-së); (Rregullore e UV-së)</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Marketing, pjesë e Departamentit të Biznesit, është hapur me VKM Nr. 270, datë 10.06.2011 me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (UMASH). Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në Marketing e regjistruar me Vendim Nr. 439, datë 09.09.2011 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Programi ka pësuar ndryshime me Vendim Senati Nr. 58, datë 06.09.2018 në masën 20% në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Këto ndryshime janë</p>




	<p>miratuar nga MASR me shkresë Nr. 10761/1, datë 25.10.2018.</p> <p>Programi i studimit lidhur me emërtimin organizimin dhe strukturën është në përputhje me drejtimin akademik të institucionit në fushën e ekonomisë e biznesit, si pjesë e këtij fakulteti.</p> <p><i>(Statuti i UV-së); (Rregullore e UV-së)</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet krejtësisht</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>✓</td> </tr> </table>			Përmbushet krejtësisht					✓
		Përmbushet krejtësisht							
			✓						

Standardi I.3

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.

Departamenti i Biznesit, si njësi bazë që ofron këtë program studimi, krahas objektivave për të shërbyer tregut dhe biznesit shqiptar, rritjes së cilësisë dhe përmirësimit të standardeve të mësimdhënies, forcimit të marrëdhënieve me studentët, vlerëson formimin e studentëve të programit bachelor në marketing me dije e kompetenca që i shërbejnë tregut dhe qëllimeve të institucionit.

Cikli i parë i studimeve në marketing synon formimin dhe kualifikim e studentëve në fushën e marketingut duke siguruar njohuritë themelore në shkencën e marketingut që të jetë i krahasueshëm me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare brenda dhe jashtë vendit.

Gjithashtu programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për profilin e programit dhe për të ndjekur ciklet e tjera të thelluara të studimit.

Në Planin Strategjik të programit të studimit Bachelor në Marketing, pika 4, janë përcaktuar 5 grupe objektiva të programit të kategorizuara për kërkimin shkencor, rritjen e cilësisë së mësimdhënies, orientimin drejt sipërmarrjes, rritjen e kontributit në komunitet dhe infrastruktura e mësimdhënies. *Vihet re se objektivat për këtë program studimi janë të përgjithshme dhe nuk dallojnë nga objektivat për programet e tjera bachelor si p.sh bachelor në*




	<p><i>administrim biznes. Ato nuk specifikojnë qartë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që karakterizojnë profilin e marketingut.</i></p> <p><i>(Plani Strategjik i programit të studimit Bachelor në Marketing 2020-2024)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga takimi me Drejtuesen e Departamentit të Biznesit dhe Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, GVJ u informua se krijimi dhe përmirësimi i programit është bazuar në studime tregu të realizuara në kuadër të projekteve në vitin 2010 nga Qendra për Ndryshim e Menaxhim Konflikti, në 2011 nga Fondi i Ekselencës, i financuar nga Ministria e Arsimit, dhe në 2017 nga Organizata Auleda. Referuar studimeve të tregut dhe eksperiencës së të shkuarës, programi ka pësuar ndryshime me Vendim Senati Nr. 58, datë 06.09.2018 në masën 20% në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Analizat e tregut të punës ka marrë në shqyrtim mundësitë për punësim dhe nevojat e tregut në sektorin e marketingut në harmoni me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.</p> <p>GVJ konstatoi se institucioni ka krijuar në vitin 2019 njësinë e Alumni dhe nga takimi i zhvilluar me Sektorin e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës u evidentua se kanë krijuar një databazë me 1500 studentë alumni <i>por nuk ka të dhëna për studentë të programit të studimit bachelor në Marketing.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon se njësia përgjegjëse e programit të studimit, në bashkëpunim me Sektorin e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës duhet të kujdeset të gjurmojë me rigorozitet e përditësojë periodikisht punësimin real të studentëve të diplomuar dhe të ndjekë zhvillimet në sektorin përkatës përmes marrëveshjeve të ngushta me tregun e punës. Njësia përgjegjëse e programit duhet të angazhohet më tepër në mundësitë e punësimit të studentëve, të cilat të evidentura statistikisht do ti shërbejnë si avantazh konkurrues i programit dhe si promotor i tij për brezat e ardhshëm.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitat në Institucion rezultojnë se ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut dhe pajis studentët me aftësitë që kërkon tregu në elementët e Marketingut. Lidhur me përmbajtjen e programit të studimit, përbëhet nga (5) lëndë bazë, (15) lëndë të formimit karakterizues (4) lëndë ndërdisiplinore, (5) lëndë plotësuese dhe Diploma.</p>




	<p>GVJ sugjeron një rishikim të lëndëve të formimit karakterizues, duke theksuar se lëndët e profilit marketing duhet të garantojnë përftimin e dijeve dhe kompetencave aktuale të profilit. Për këtë nevojitet të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së lëndëve Marketing Dixhital, Komunikimi i integruar marketing, Inovacion, dhe në vend të përsëritjes të lëndëve karakterizuese Strategji Marketing dhe Marketing Strategjik, të shikohet mundësia e integritimit të njëjës lëndë në Planifikim Marketing me aplikim praktik në biznese. Gjithashtu, GVJ sugjeron integrimin e praktikës mësimore në semestrin e fundit me qëllim aftësimin e studentëve në tregun e punës.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="603 696 807 768"></td> <td data-bbox="807 696 1011 768"></td> <td data-bbox="1011 696 1216 768"> <p>Përmbushet kryesisht</p> </td> <td data-bbox="1216 696 1366 768"></td> </tr> <tr> <td data-bbox="603 768 807 813"></td> <td data-bbox="807 768 1011 813"></td> <td data-bbox="1011 768 1216 813" style="text-align: center;">✓</td> <td data-bbox="1216 768 1366 813"></td> </tr> </table>			<p>Përmbushet kryesisht</p>				✓	
		<p>Përmbushet kryesisht</p>							
		✓							

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>UV ka përvojën dhe kapacitetet në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të këtij institucioni dhe ofrimin e programit të studimit Bachelor në Marketing. Ky program ofrohet nga Departamenti i Biznesit, njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë i cili nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik si edhe shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Në Statutin dhe Rregulloren e UV gjejmë mënyrën e organizimit të institucionit, kompetencat e organeve drejtuese akademike, kolegjiale dhe administrative të institucionit. Hartimi i programit bachelor në Marketing vë në efikasitet burimet njerëzore të UV pasi integron stafin e departamenteve të tjera me qëllim marrjen e njohurive dhe kompetencave bazë në ekonomi e biznes dhe plotësimin e profilizimit në marketing.</p> <p>Sipas evidencës (Ngarkesa e Personelit Akademik të programit Bachelor në Marketing), aktualisht për programin Bachelor në Marketing janë angazhuar gjithsej 27 pedagogë, nga të cilët 25 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 2 pedagogë me kontratë (PAK). Sipas të dhënave të tre viteve të fundit të personelit akademik të njësisë përgjegjëse, Departamenti i Biznesit përbëhet nga 16 PAE</p>

	<p>dhe 3 PAK (vitit 2019-2020) ku 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 11 kanë gradën Dr./PhD, dhe 1 Asistent Lektorë me Dr. në proces; dhe 1 personel ndihës akademik. Krahasuar me dy vitet akademike paraardhëse (2018-2019; 2017-2018), nuk ka ndryshuar numri i personelit PAE dhe është zvogëluar numri i personelit PAK nga 6 në 3 pedagogë. Këto ndryshime kanë ardhur në përputhje me zvogëlimin e numrit të studentëve në dy vitet e fundit.</p> <p>UV nuk ka pasur lëvizje të konsiderueshme të stafit akademik çka nuk çënon ofrimin e programit të studimit. Raporti PAE/PAK i stafit të angazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2019-2020 rezulton 93% me 7% çka tregon qëndrueshmëri në burimet e programit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimi me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe takimet me stafin u vu re një rekrutim i ulët i stafit të ri.</p> <p><i>(Statuti i UV-së); (Rregullore e UV-së); (Ngarkesa e Personelit Akademik të programit Bachelor në Marketing); Aneksi 1</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësish kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>UV vepron brenda kornizave ligjore dhe respekton ligjin e Arsimit të Lartë në fuqi (L.80/2015 Neni 23 pika 1) dhe përcaktimet statutoare. Strukturat janë të formuara që të garantojnë arritjen e misionit të UV në pëmbushje të autonomisë akademike. Stafi akademik i UV ka konsoliduar strukturën e kërkimit shkencor dhe zhvilluar objektivat e kërkimit në përputhje me fushën përkatëse të formimit të specifikuar dhe në Planin Strategjik të Programit të Studimit 2020-2024.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me Stafin Akademik u pohua se personeli është nxitur të marrë pjesë në projekte kërkimore, konferenca e aktivitete të tjera shkencore, të publikojë rezultatet e punës kërkimore, duke përfutur edhe mbështetje financiare përmes akordimit të granteve kërkimore.</p> <p>Programi i Studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të vendosur nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësish bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti Biznesit. Fusha kërkimore dhe akademike e kësaj njësie bazë rezulton të jetë në koherencë me programin e studimit sipas klasifikimit të këtij të fundit.</p>




direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushur kryesisht	Përmbushur plotësisht ✓

Standardi 1.5
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga vizita në Institucion, GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Marketing, Departamenti i Biznesit si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe angazhuar staf të kualifikuar. Një pjesë e lëndëve bazë të programit mbulohen nga stafi i Departamentit, ndërsa angazhohet staf nga departamentet e tjera të Fakultetit të Ekonomisë UV për lëndët e formimit karakterizues dhe lëndë plotësuese. Programi është organizuar me profilizim në marketing që lejojnë bashkërendim të stafit ndër disiplina e formim ekonomie, biznesi e marketingu, ku dhe Departamenti i Biznesit angazhohet në programe studimi të njësive të tjera. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikqyret nga instancat drejtuese të UV duke filluar nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, NJSBC etj. Çdo vit akademik realizohet dhe një analizë e punës së njësive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e UV-së.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, UV ka marrëveshje me institucione brenda dhe jashtë vendit për shkëmbim ekspertize në funksion të procesit mësimor dhe realizimin të objektivave të programit të studimit. Siç u pohua nga takimi me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit, një bashkëpunim të gjerë UV ka me Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me të cilin është hartuar ky program. Ndërsa numëron një numër të konsiderueshëm bashkëpunimesh me universitete evropiane në Itali, Greqi, Estoni, Spanjë etj, për projekte kërkimore e shkëmbim ekspertize.</p> <p>Gjithashtu UV ka krijuar disa marrëveshje bashkëpunimi me Institucione homologe ndërkombëtare përmes programeve</p>

	Erasmus+ dhe Mevlana me objekt shkëmbimin e burimeve njerëzore dhe ndërtimin e programeve të reja të studimit. <i>(Referuar Raportit Vjetor të UV për Bashkëpunime Ndërinstitucionale)</i>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në fund të vitit akademik, departamenti bën analizën e punës mësimore dhe shkencore, ku përveç aspekteve të tjera të punës për mbarëvajtjen e programit të studimit, shqyrton dhe analizon marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera. Në këto analiza evidentohen përfitimet konkrete në funksion të realizimit të programit mësimor.</p> <p><i>GVJ konstaton se UV ka krijuar marrëveshje të suksesshme bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, por nevojiten të bëhen marrëveshje bashkëpunimi me biznesin në funksion të rritjes së aftësive praktike të studentëve dhe arritjen e qëllimeve të programit të studimit. GVJ sugjeron një angazhim më të madh të Zyrës së Karrierës dhe Njesisë përgjegjëse për të kontribuar në integrimin e praktikës mësimore të studentëve në planin mësimor të programit Bachelor në Marketing (siç qëndron në programe e tjera bachelor të njesisë) dhe organizimin e saj me punëdhënës të bizneseve lokale. Nga takimi i GVJ me studentët rezultoi se ata ishin të paorientuar lidhur me praktikën e punës, aftësive në punë dhe zhvillimeve të tregut të punës. GVJ rekomandon të orientohen studentët drejt aftësive praktike, mënyrës së kërkimit të punësimit më të mirë që u përshtatet me programin e studimit. Gjithashtu, GVJ sugjeron zhvillimin e kurrikulës së studimit drejt këtij komponenti dhe nëse është nevoja të shtohen lëndë si menaxhimi i karierrës për të përgatitur studentët në hapat drejt tregut të punës e kualifikimeve të mëtejshme.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në Marketing nuk e ka të parashikuar praktikën mësimore në planin mësimor të tij. Referuar dhe kriterit 3, GVJ sugjeron se është e domosdoshme vendosja e praktikës së punës për rritjen e aftësive praktike të studentëve dhe arritjen e qëllimeve të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Marketing synon arsimim shkencor e profesional të studentëve në fushën e Marketingut, duke pajisur studentët me njohuritë themelore të fushës. Programi synon të zhvillojë shprehitë, kompetencat dhe aftësitë e studentëve në marketingun e bizneseve. Ky program ka një rendësi në rritje si pasojë e rëndësisë që ka marrë marketingu në ekonominë shqiptare. Në funksion të këtij qëllimi institucioni angazhon zyrat mbështetëse si Zyra e Karrierës dhe Zyra Alumni për mbajtjen e marrëdhënieve me studentët përmes gjurmimit të tyre si instrument vlerësues për</p>




	<p>kërkesat e tregut dhe aset për pozicionimin e institucionit. Megjithë vështirësitë e shumta që Zyra e Alumni përballet në gjurmimin e të diplomuarve, ajo është në mbështetje të studentëve dhe pas përfundimit të studimeve. Organizimi i panairit të punës në Maj 2019 dhe takime me bizneset kanë qënë ndër aktivitetet e organizuara prej saj ku kanë marrë pjesë dhe student të diplomuar. <i>Departamenti i Biznesit është në faze planifikimi për trajtime të mëtejshme profesionale me të diplomuar dhe GVJ konstaton që nuk është kryer ende asnjë i tillë në funksion të programit të studimit, ndërsa referuar Statutit të UV-së është ngritur qendra studimore ndërdisiplinore për trajnime e edukim të vazhdueshëm.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet kryesisht	✓
---	--	----------------------	---

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit Bachelor në “Marketing” ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, i cili përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Biznesit • Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit • Departamenti i Ekonomiksit • Qendra e Kërkimit Shkencor e Fakultetit të Ekonomisë. <p>Programi i studimit Bachelor në Marketing, pjesë e Departamentit të Biznesit, është hapur me VKM Nr. 270, datë 10.06.2011. Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (UMASH). Programi i ciklit të parë ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe dhe kohëzgjatja e tij është 3 vite akademike, me 180 ECTS. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në “Marketing” e regjistruar me Vendim Nr.</p>

	<p>439, datë 09.09.2011 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Programi ka pësuar ndryshime me Vendim Senati Nr. 58, datë 06.09.2018 në masën 20% në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Këto ndryshime janë miratuar edhe nga MASR me shkresë Nr. 10761/1, datë 25.10.2018. Programi i studimit nuk ka kaluar më parë proces akreditimi.</p> <p>GVJ gjykon që Programi i studimit Bachelor në Marketing plotëson në tërësi kriteret sa i takon rëndësisë së programit për nevojat e ekonomisë, rritjes së kërkesës për profesionistë marketing në fusha të ndryshme të aktiviteteve ekonomike, organizimit dhe administrimit me një staf të kualifikuar, mësimdhënies e mësimnxënies për realizimin me cilësi të programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga Lëndë Bazë (5 lëndë/32 ECTS), Lëndë Karakterizuese (15lëndë/95ECTS),Lëndë Ndërdisciplinore (8 lëndë, nga të cilat 6 janë me zgjedhje, në varësi të profilit/24 ECTS), Lëndë Plotësuese (5 lëndë, nga të cilat 1 lëndë është gjuhë e huaj/23 ECTS) si edhe Diploma/Provimi Përgjithshëm Përfundimtar/6 ECTS. Duhet nënvizuar se programi ofron mundësinë e zgjedhjes të një nga 5 gjuhë të huaja.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>GVJ, pasi analizoi programin e studimit, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe pas diskutimeve me stafin akademik të institucionin, gjykon që programi që vlerësohet realizon formimin e shprehive të veçanta dhe aftësimin e profesionistëve të ardhshëm me qëllim që t’iu përgjigjet më mire nevojave të tregut, mbështetur edhe në eksperiencën e institucionit, i cili e ka ofruar profilin e Marketingut, prej vitit 1994.</p> <p>Prej vitit 2011, institucioni ofron Programin Marketing si Diplomë e veçantë. Ky ndryshim është udhëhequr nga analiza e nevojave të tregut kryesisht, por edhe për të siguruar fleksibilitetin e nevojshëm dhe lehtësuar transferimin e studentëve në institucione të tjera të vendit ose jashtë vendit.</p> <p>Programi në ciklin e parë, Bachelor në Marketing, synon arsimimin dhe kualifikimin e studentëve në fushën e marketingut, duke iu siguruar njohuri themelore nëpërmjet integritit të teorisë me praktikën, kjo nëpërmjet përfshirjes së lëndëve që mbështeten mbi shprehitë praktike, të përshtatshme</p>




	<p>për specializimin e tyre në Marketing (rreth 50% e lëndëve). (Evidenca 5.6)</p> <p>Përcaktimi i rezultateve të të nxënit në programet mësimore (syllabuset e lëndëve) të secilës lëndë, ndihmon vlerësimin e arritjeve të studentëve në drejtim të formimit të shprehive të veçanta.</p> <p><i>GVJ gjykon që vështirë të pranohet se programi garanton llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh, sepse mundësitë e zgjedhjeve janë të kufizuara. Mungesa e praktikës gjithashtu si komponent i veprimtarisë mësimore, ndikon në shkallën e aftësisë të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Konstatohet se programi Bachelor në Marketing ofron njohuri të përparura në fushën e studimit, përfundim i cili mbështetet nga pesha e lëndëve të marketingut, që është e konsiderueshme, sipas të dhënave të evidences 5.6, “Programi mësimor”.</p> <p>Të njëjtin këndvështrim kanë edhe studentët e regjistruar në këtë program. Lëndët e përfshira në këtë program, përmbajtja e tyre si edhe metoda e mësimdhënies sigurojnë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të Marketingut, e cila përforcohet nga pjesëmarrja në leksione e të ftuarve, si nga fusha akademike ashtu edhe organizatat e njohura të biznesit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Si rrjedhojë e përpunimit të të dhënave të disponuara, GVJ konstatoi se programi i studimit ka pësuar ndryshime, kryesisht në vitin 2014, 2016 dhe 2018, ndryshime të cilat janë udhëhequr nga kërkesat e kuadrit ligjor, me qëllim rritjen e cilësisë në arsimin e lartë (Evidenca 2.13).</p> <p>Përtej kësaj, institucioni ndjek me vëmendje ndryshimet dhe përmirësimet në institucione të tjera të vendit, kryesisht të Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës, me të cilin ka marrëdhënie bashkëpunimi të qëndrueshme. Për rrjedhojë, programi është plotësisht i përshtatshëm për të zhvilluar njohuri dhe kompetenca bashkëkohore në fushën e Marketingut.</p> <p>Gjithashtu, evidencat tregojnë se institucioni jo vetëm ndjek me vëmendje ndryshimet në drejtim të përmirësimit të programit mësimor në vend, por iu referohet edhe eksperiencave më të përparura në sajë të bashkëpunimeve me universitete të tjera jashtë vendit si edhe njohurive të fituara nga stafi akademik, gjatë realizimit të programeve afatgjata të kualifikimit jashtë vendit.</p>




<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të 21ate përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit i ciklit të parë, që vlerësohet, respekton me rreptësi strukturën e programit të studimit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, përkatësisht: Lëndët bazë përbëjnë 17%, lëndët karakterizuese përbëjnë 53%, lëndët ndërdisiplinore përbëjnë 13%, lëndët plotësuese përbëjnë 13 % dhe detyrimet përmbyllëse 3%.</p> <p>Pavarësisht kësaj, GVJ gjykon që komenti në lidhje me përfshirjen e praktikës tek grupi i lëndëve plotësuese, është i vlefshëm, sepse do të rriste mundësitë e studentëve për të njohur dhe përvetësuar konceptet praktike të profesionit.</p> <p>Gjithashtu, GVJ gjykon që Departamenti diskuton dhe vendos mbi pozicionimin e lëndëve “Menaxhim i Burimeve Njerëzore” dhe “Sjellje Organizative”.</p>								
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Ndonëse stafi akademik është i mendimit që programi i riorganizuar, në të cilin Marketingu nga profil është transformuar në drejtim të pavarur i përgjigjet më mire kërkesave të tregut, GVJ gjykon që evidencat e paraqitura janë të pamjaftueshme për të arritur në këtë përfundim.</p> <p><i>Një analizë e mirfilltë tregu, që të prëfshijë jo vetëm Bashkinë Vlorë, por edhe bashkitë fqinje, të rinjtë e të cilave frekuentojnë Universitetin e Vlorës, duhet të realizohet, për të mbështetur jo vetëm ndryshimin e realizuar, por edhe mund të sugjerojë ndryshime të tjera të cilat do të ndikojnë në rritjen e cilësisë të programit akademik si edhe të përshtatshmërisë dhe përpuethshmërisë me kërkesat në rritje të tregut.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> <td></td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			✓	
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		✓							


<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë, “Universiteti i Vlorës” është krijuar me vendim Nr. 105, datë 28.02.1994 me propozim të Ministrisë së Arsimit, Këshillit të Ministrave, me emërtimin “Universiteti i Vlorës” dhe është riorganizuar me vendim Nr. 822, datë 05.12.2007 me emërtimin Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.</p>

	<p>Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 71, datë 21.09.2017 për akreditimin institucional të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë me kohëzgjatje 3 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 30.09.2020.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Marketing ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë. Ky fakultet përbëhet nga tre departamente si edhe nga një qendër kërkimore, siç vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Biznesit • Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit • Departamenti i Ekonomiksit • Qendra e Kërkimit Shkencor e Fakultetit të Ekonomisë <p>Sipas të dhënave të tre viteve të fundit (Tabela 1 e PVB si edhe Evidenca 4.1) të personelit akademik të njësisë përgjegjëse, Departamenti i Biznesit përbëhet nga 16 PAE dhe 3 PAK (vitit 2019-2020) ku 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 11 kanë gradën Dr./PhD, dhe 1 Asistent Lektorë me Dr. në proces; dhe 1 personel ndihës akademik. Krahasuar me dy vitet akademike paraardhëse (2018-2019; 2017-2018), nuk ka ndryshuar numri i personelit PAE dhe është zvogëluar numri personelit PAK nga 6 në 3 pedagogë. Këto ndryshime kanë ardhur në përputhje me zvogëlimin e numrit të studentëve në dy vitet e fundit.</p> <p>GVJ gjykon që njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit të Njesisë bazë, veçanërisht i rregullores së departamentit të Biznesit, pjesë e të cilit është Programi Bachelor në Marketing, konfirmoi se njësia bazë ka caktuar një person përgjegjës për çdo program studimi, nën emërtimin “Përgjegjës i grupit mësimor”.</p> <p>Departamenti i Biznesit përbëhet nga dy grupe mësimore, përkatësisht Grupi Mësimor i Biznesit dhe ai i Marketing-Turizëm. Përgjegjësi i grupit mësimor kryen detyra akademike në funksion të përgjegjësit të njësisë bazë, duke vepruar gjithmonë sipas udhëzimeve të tij. Përgjegjësi i grupit mësimor “Marketing” nuk mbulon praktikat profesionale meqenëse ato nuk janë pjesë e programit mësimor.</p>




<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Siç rezulton nga dokumentat themelore rregullatore të hartuara nga institucioni dhe njësia bazë, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë ndërtuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi (Evidenca 3.2, Vendim i Senatit Akademik Nr.8, date 14.02.2018, “Për Strukturën Organizative të UV”).</p> <p>Departamenti i Biznesit, përgjegjës për programin Bachelor në Marketing, disponon informacionet e nevojshme, si ato që transmetohen nga strukturat eprore institucionale ashtu edhe ato që hartohen brenda departamentit, në përputhje me organigramën dhe organizimin hierarkik të prodhimit dhe qarkullimit të informacionit.</p> <p>Legjislacioni udhëheqës (Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministratve) për veprimtarinë e Institucioneve të Arsimit të Lartë, analizohet në Rektorat dhe mbi këtë bazë, hartohen dokumentat kryesore rregullatore në nivel institucioni. Ky dokumentacion përfshin vendime të brendshme, udhëzime, rregullore si edhe statuti, të cilat vijnë të protokolluara dhe sipas afateve nga rektorati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, duke miratuar rregulloret përkatëse dhe përcjellë informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet.(Evidenca A “Statuti I UV”, Evidenca C, “Rregullore e UV, e ndryshuar”.</p> <p>Gjithashtu Departamenti ka hartuar Rregulloren për veprimtarinë e brendshme të tij, në të cilën përcaktohen marrëdhëniet e departamentit me studentët (Rregullore e departamentit, miratuar me Vendim Senati Akademik Nr. 5, date 9.01.2020, Evidence 2.4) si edhe rregulloret për secilin nga Programet e Studimit, të secilit cikël studimi, përfshirë edhe Rregulloren e Programit Bachelor në Marketing, e cila është miratuar, së bashku me rregulloret e tjera, me Vendim të Senatit Akademik, Nr. 2. Datë 9.01.2020 (Evidenca 2.5).</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar mbi synimet dhe objektivat e programit të studimit, të paraqitura tek “Plani Strategjik i Departamentit të Biznesit, 2018-2024” (Evidenca 1.1.), lehtësisht konstatohet rëndësia dhe vëmëndja që i kushton departamenti formimit të duhur sipas lëndëve të kategorizuara sipas legjislacionit në fuqi.</p>

	<p>Programin që po vlerësohet, Bachelor në Marketing, është ndërtuar sipas 4 drejtimeve themelore, përkatësisht Lëndë Bazë, Karakterizuese, Ndërdisciplinore dhe Plotësuese, në përmbajtjen e të cilave janë klasifikuar lëndët në aktivitete formuese dhe aktivitete praktike (Evidenca 5.6).</p> <p><i>Siç u komentua edhe në pikën II.1, GVJ nënvizon se në program nuk është parashikuar praktikë mësimore, ndonëse siç mund të evidentohet nga analiza e syllabuseve, në çdo modul është lënë një hapësirë pjesës praktike lidhur me projekte konkrete të kursit, rastet studimore nga praktika sidomos shqiptare, si edhe vizita nga lektorë të ftuar, të cilat pavarësisht vlerës, nuk mund të zëvendësojnë rolin e praktikës mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Marketing, bazohet në sistemin e vlerësimit me kredite ECTS, sistem i cili është pranuar gjerësisht në nivel Europian dhe në nivel kombëtar, në përputhje me kartën e Bolonjës, duke krijuar mundësinë e krahasimit të ngarkesës së nevojshme për realizimin e secilës lëndë që përbën një program studimi.</p> <p>Programi i studimit Bsc në Marketing realizohet në 3 vite akademike ose 6 semestra me një total prej 180 ECTS, 60 ECTS per secilin vit akademik. Një semester përmban 15 jave mësimore ose 30 ECTS.</p> <p>Kreditet e secilës lëndë së bashku me peshën specifike të grup lëndës (përqindja ndaj totalit) ndihmojnë studentin të kuptojë ngarkesën e përgjithshme, vjetore dhe atë semestrale.</p> <p>Ai gjithashtu pasqyron kritere për kalimin e të gjitha provimeve si edhe instrumentin për të vëzhguar ecurinë e studentit nga një vit akademik tek tjetri, deri në përfundimin e plotë të studimeve. (Evidenca 5.6, Planet Mësimore si edhe Evidenca 2.4, Rregullorja e Departamentit të Biznesit).</p> <p>Konkretisht ndarja në semestra është sipas një balancimi, ku lëndët bazë dhe ato karakterizuese, 6 kredite dhe 7 kredite janë të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme ndërmjet semestrave të secilit vit akademik.</p> <p>Lëndët dhe shpërndarja e tyre me kreditet, orët mësimore</p>




	në auditor dhe jashtë auditorit, që zënë modulet e kategorive të ndryshme janë në zbatim të Vendimit nr 41, date 24.01.2018, udhëzimeve të MASR dhe rregulloreve të institucionit dhe programit (Evidenca 5.6, Plani Mësimor).
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	<p>Programi i studimit Bachelor në Marketing është i mbështetur në Planin Strategjik të Zhvillimit të Programit të Studimit (Evidenca 1.4) si edhe në Planin përkatës mësimor (Evidenca 5.6). Në këto dokumenta përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor në Marketing. Në këtë plan, ngarkesa e një viti akademik (60ECTS) është llogaritur 1,500 orë, (60ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.</p> <p>Gjithashtu, Njësia Bazë ka përcaktuar të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me frekuentimin, ndjekjen e programit si edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Këto element përveç se të përcaktuara në Rregulloren e departamentit (standardet bazë), janë gjithashtu të përcaktuara në syllabusin e secilës lëndë.</p>
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Njësia Bazë ka përpunuar informacione të detajuara, të cilat ju përcillen studentëve nëpërmjet disa dokumentave thelbësore, siç janë: rregullorja e Programit Bachelor në Marketing (Evidenca 2.5), Rregullorja e Universitetit (Evidenca C), si edhe Rregullorja e Departamentit (Evidenca 2.4). Këto dokumenta përcaktojnë të gjithë elementët dhe mekanizmat e duhur për të rregulluar marrëdhëniet e studentëve me institucionin, në funksion të realizimit të qëllimit të tyre si: regjistrimi, ndjekja, përfundimi i studimeve dhe diplomimi në programin e studimit, Bachelor në Marketing.</p> <p>GVJ gjykon që vlen për t'u nënvizuar vëmëndja e institucionit në raport me procedurat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Nisur nga kërkesat e studentëve për të vazhduar studimet në ciklin e dytë në Tiranë ose jashtë vendit, Njësia bazë është kujdesur që programi i studimit të jetë i krahasueshëm me programme të tjera të së njëjtës natyrë, me qëllim që të lehtësojë ekuivalentimin dhe transferimin e studimeve, në përputhje me kërkesën e studentëve.</p>
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë	Analiza e Syllabuseve të detajuara të lëndëve (Evidenca





<p>informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>2.6) dëshmon se informacioni mbi përmbajtjen dhe formën e organizimit të mësimdhënies, për secilën lëndë të programit, është i detajuar, i plotë dhe i lehtë për t'u përdorur. Syllabusi përmban: Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, tematikën e secilës orë mësimi, formën e kontrollit të dijeve dhe literaturën. Formatet e syllabuseve përputhet me standartet e përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Syllabusi, i përgatitur nga pedagogu i lëndës, depozitohet i firmosur, tek Njësia Bazë, përpara fillimit të semestrit. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për prezantimin e syllabusit si edhe sqarimin e modaliteteve të ndjekjes së lëndës, në orën e parë të mësimi. GVJ konstaton se programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme në lidhje me kërkesat e kriterit 6.</p>								
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Me qëllim plotësimin më të mirë të nevojave të tregut si edhe të kërkesave të studentëve, program i studimit Bachelor në Marketing është riorganizuar (Evidenca 2.13), në përputhje me udhëzimet e MARS.</p> <p>Ndryshimet dhe përshtatjet e propozuara nga Njësia dhe të miratuara nga Senati, përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rivlerësim kredite të disa lëndëve dhe të diplomës. • Krijimin e një disipline të re. • Ndryshim emërtimi të disa disiplinave. • Ndryshim të ngarkesës mësimore në lëndën e Marketingut të Shërbimeve. • Riorganizim të dy disiplinave ekzistuese. <p>Të gjitha këto ndryshime nuk e kalojnë kufirin e 20% të programit.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td style="background-color: black; color: white;">Përmbushet plotësisht</td> <td style="background-color: black; color: white;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: black; color: white;">Përmbushet pjesisht</td> <td style="background-color: black; color: white;">Përmbushet jo plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">✓</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesisht	Përmbushet jo plotësisht				✓
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesisht	Përmbushet jo plotësisht						
			✓						

<p>Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në</p>	<p>Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë, në nenin 70 pika 4, përcakton mënyrën e organizimit të programeve të studimit në</p>

fuqi.	<p>Institucionet e Arsimit të Lartë, në tre cikle të njëpasnjëshme.</p> <p>Rregullorja (Evidenca A) dhe Statuti (Evidenca C) i UV konfirmojnë se UV ofron programe studimi në dy cikle. Ngarkesa e programit përmban 180 kredite të shtrira përgjatë tre viteve akademike, në 6 semestra, përkatësisht dy semestra në një vit akademik.</p> <p>Ngarkesa në orë mësimore dhe orë jashtë auditorit është përcaktuar tek Plani Mësimor i programit (Evidenca 5.6).</p> <p>Gjatë vitit akademik 2019-2020, referuar Tabelës 4 (Informacion shtesë Marketing) janë realizuar 8805 orë gjithsej nga stafi PAE dhe PAK. Ndërsa stafi PAE ka realizuar 8580 orë ose 97.5% të ngarkesës së përgjithshme, stafi PAK ka realizuar vetëm 225 orë ose 2.5% të ngarkesës së përgjithshme.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programin që po vlerësohet, Bachelor në Marketing është ndërtuar sipas 5 drejtimeve themelore, përkatësisht Lëndë Bazë, Karakterizuese, Ndërdisciplinore, Plotësuese dhe Detyrime Përmbyllëse, në përmbajtjen e të cilave janë klasifikuar lëndët në aktivitete formuese dhe aktivitete praktike (Evidenca 5.6), në funksion të programit të studimit si edhe për të rritur mundësitë e punësimit të studentëve, nëpërmjet rritjes së nivelit profesional të tyre.</p> <p>Të gjitha veprimtaritë akademike si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime si dhe kontrolli i vazhdueshëm) janë në funksion të arritjes të objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodatat e mësimdhënies mbështetin të mësuarit interaktiv si edhe nxitjen e mendimit të tyre krijues. (Vendim Nr.1, datë 13.01.2020, “Miratim i udhëzuesit mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies”.)</p> <p>Bashkëpunimi me organizatat e biznesit nëpërmjet të ftuarve dhe/ose vizitave mbështet tranzicionin e studentëve nga shkolla në tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>Siç konstatohet nga evidenca 5.6 (Plani mësimor) si edhe nga diskutimet në institucion, shpërndarja e lëndëve ndërmjet viteve dhe semestrave synon të ofrojë njohuri gradualisht të përshkallëzuara. Kështu, në vitin e parë dhe të dytë ofrohen kryesisht disiplinat e njohurive të përgjithshme, ndërsa në vitin e tretë sigurohen njohuritë e detajuara profesionale.</p>




	<p>Evidenca 1.4 dhe 5.6 sigurojnë informacion të mjaftueshëm dhe të detajuar mbi ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 180 ECTS për të fituar Diplomën Bachelor në Marketing. Ngarkesa e një viti akademik (60ECTS) është llogaritur 1,500 orë, (60ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Informacioni i siguruar nga shqyrtimi i Rregullores së Programit Bachelor në Marketing (Evidenca 2.5) konfirmon se ky program studimi ju siguron studentëve Diplomë Bachelor në “Marketing”, në sajë të së cilës ata mund të ushtrojnë profesionin si specialistë të marketingut, promocionit, shitjes, reklamimit, marëdhënieve me publikun, etj, në organizata të ndryshme. Programi i studimit është ndërtuar plotësisht në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si edhe profilin e profesionistit të fushës përkatëse, marketingut.</p> <p>Plani mësimor (Evidenca 5.6) përveç argumentave të mbështetura në analizën e kriterëve të standartit II.1, II.2 dhe II.3, shërben gjithashtu për të verifikuar mënyrën e organizimit të lëndëve të përgjithshme ndaj lëndëve specifike të profesionit. Siç konstatohet, lëndët e profesionit kryesisht realizohen në vitin e tretë të studimeve, së bashku me detyrimet përfundimtare, Diplomën ose provimin e Përgjithshëm Përfundimtar.</p> <p><i>Ndonëse raporti teori/praktikë në kuadrin e çdo lënde është në përputhje të plotë me profilin e programit, në kuadrin e përgjithshëm të studimeve, vështirë të pranohet i njëjti përfundim, sepse “veprimtaria praktike” në kuptimin e detyrimeve plotësuese ose përmbyllëse, nuk është parashikuar në program.</i></p> <p>GVJ konkludon se struktura e programit i përafrohet programeve të ngjashme ndërkombëtare, ndonëse unifikimi mbetet një sfidë e departamentit dhe institucionit, për të cilën stafi dhe drejtuesit, janë të ndërgjegjshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Objektivat formuese të programit, të specifikuar tek Plani Strategjik i Programit të Studimit, (Evidenca 1.4) dhe Rregullorja e Programit (Evidenca 2.5), janë plotësisht të mbështetura nga struktura dhe organizimi i planit mësimor (Evidenca 5.6).</p> <p>Objektivat formuese të secilës lëndë janë të formuluar në mënyrë të qartë tek syllabuset përkatëse (Evidenca 2.6). GVJ</p>




	<p>gjykon që arritja e objektivave formuese në çdo lëndë është e mbështetur nga struktura e lëndës, në veçanti nga ndarja ndërmjet veprimtarive formuese si sipas lëndëve ashtu edhe sipas programit të përgjithshëm të studimeve akademike në Marketing, cikli i parë.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Përmirësimi i përmbajtjes së lëndëve dhe moduleve është objekt i diskutimit në departament, bazuar në diskutimet me personelin e departamentit. Këtij qëllimi i shërben eksperiencia e fituar nga pjesëmarrja në programe kualifikimi jashtë vendit e disa pedagogëve si edhe këmbimi i eksperiencës me disa universitete të cilat aplikojnë programe të ngjashme.</p> <p>Programet e lëndëve përditësohen çdo vit akademik. Përditësimi përfshin literature bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi si edhe metoda më efektive e të përparuara të mësimdhënies.</p> <p>Ndryshimet në literature miratohen çdo vit akademik. Literatura e çdo lënde, si literature e detyrueshme, ashtu edhe ajo alternative, janë pjesë e syllabusit të lëndës.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive mbi Bazat e Marketingut, Marketingun Strategjik, Kërkimin Marketing, Marketingun e Shërbimeve, Marketingun Ndërkombëtar, Strategjitë e Marketingut, Promocionin, të cilat janë disiplina thelbësore në formimin “Marketing”, si edhe harmonizim të njohurive me disiplina me zgjedhje si “E Drejta e Biznesit”, “Biznesi i Vogël”, “Sistemet e Informacionit” etj.</p> <p><i>Sidoqoftë, GVJ konstaton mungesën e evidencave specifike për identifikimin e të dhënave mbi punësimin e studentëve si dhe analiza të ecurisë bazuar mbi vlerësimin e përmbajtjes së programit.</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nisur nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objektivat formuese të programit; • Harmonizimi i lëndëve bazë dhe karakterizuese me ato me zgjedhje dhe plotësuese; • Ndërthurja e njohurive teorike dhe praktike; • Përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës; • Përmirësimi i metodave të mësimdhënies; • Kriteret e pranimit dhe transferimit, <p>GVJ mbështetet përfundimin se program i studimit jo vetëm</p>




	<p>mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, por edhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Gjithsesi, pa mohuar vlerën e evidencave të renditura më lart, mungesa e një studimi të mirfilltë tregu, mund të ndikojë në cënimin e objektivave formuese të programit si edhe në mosrealizimin e pritshmërive të studentëve. Në planin afatgjatë, kjo mangësi mund të shkaktojë ndikime më komplekse, që mund të çënojnë aktivitetin e të njësisë bazë dhe të gjithë institucionit.</p>								
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Njësia bazë sikundër i gjithë UV organizon programe kualifikimi, seminare dhe diskutime, me fokus “Marëdhëniet me tregun e punës dhe mënyrat e nxitjes së karrierës të studentëve”.</p> <p>Megjithatë, evidencat të cilat të dëshmojnë efektivitetin e këtyre bashkëpunimeve si edhe të tregojnë shkallën e ndikimit të “eksperiencave dhe sugjerimeve të tregut të punës” në përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, mungojnë.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>✓</td> <td></td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			✓	
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		✓							

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit, i përmbush kërkesat ligjore, të përcaktuara në Ligjin për arsimin e lartë, ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur tek të dhënat e tabelës 6.1 si edhe të evidencave 5.6, vërehet se personeli akademik me kohë të pjesshme përbën vetëm 8% të personelit akademik të përgjithshëm të angazhuar.</p> <p>GVJ konfirmon se personeli i angazhuar ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik, sepse rreth 25% e stafit përbëhet nga Pedagogë të nivelit të lartë të kualifikimit, përkatësisht nga</p>




	Profesorë dhe Profesorë të Asociuar, 50% e lëndëve zhvillohen nga staf akademik me gradën “Doktor”, ndërsa vetëm 25% e stafit janë Asistent Lektorë.										
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	<p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij.</p> <p>Programi Bachelor në Marketing, për vitin akademik 2019-2020 realizohet nga 26 pedagogë PAE dhe 2 PAK, nga të cilët 7 pedagogë janë pjesë e Departamentit të Biznesit. Pedagogët e tjerë, përkatësisht nga departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, departamente të fakultetit Ekonomik, nga Fakulteti i Shkencave Teknike dhe nga Fakulteti i Shkencave Humane, mbulojnë disiplinat përkatëse, duke realizuar një përputhje të plotë të formimit të tyre me kërkesat e programit akademik. (Evidenca 5.6).</p>										
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Kjo pikë nuk është e aplikueshme për këtë program sepse programi Bachelor në Marketing nuk parashikon “Praktika Mësimore për Studentët”.</p> <p>Praktikat mësimore janë përfshirë në programin akademik të ciklit të dytë.</p>										
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Siç konstatohet nga Rregullorja e Departamentit (Evidenca 2.4 dhe 2.5) si edhe nga takimet në institucion, rezulton se Fakulteti i Ekonomisë mbështet dhe siguron mbarëvajtjen e aktiviteteve mësimore që realizohen nëpër laboratore e mjedise të tjera mësimore.</p> <p>Gjithashtu Fakulteti i Ekonomisë vë në dispozicion personel ndihmës mësimor shkencor për të mundësuar realizimin e orëve laboratorike dhe ndihmës mësimor, për të garantuar mirëmbajtjen e laboratorëve apo ambienteve të tjera të nevojshme për realizimin e programit mësimor apo realizimin e punës të pavarur të studentëve.</p>										
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="2"></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>✓</td> </tr> </tbody> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet					✓
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet							
				✓							

Shkalla e përmbushjes së

Përmbushet




standardeve të fushës II			Kryesisht		✓
--------------------------	--	--	-----------	--	---

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se njësi përgjegjëse e programit të studimit në bashkëpunim me NJSBC dhe Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve kujdeset për monitorimin e procesit mësimor dhe garantimin e mësimdhënies cilësore duke marrë veprime konkrete përmirësuese në nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. UV angazhon personelin akademik në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit e cila i mundëson ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushës. Institucioni ka bërë përpjekje në drejtim të planifikimit të metodave inovative të mësimdhënies duke hartuar dhe një draft udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e tyre. (Udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies). Zbatimi bëhet në nivel Rektorati, Dekani dhe Përgjegjësi i Njësisë sipas planit të masave të ngritura në nivel institucional.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse të personelit akademik realizohet në mënyrë periodike nga NJSBC në bashkëpunim me struktura përgjegjëse për zhvillimin e monitorimin e mësimdhënies. Si instrument për monitorimin e aftësive të mësimdhënies përdoret pyetëtori, rezultatet e të cilit përpunohen në Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sipas procedurës për analizën dhe vlerësimin e pyetësorëve për cilësinë e mësimdhënies, miratuar datë 08.05.2018, NJSBC prej dy vitesh bën analizën e rezultateve të anketimit dhe harton raportin së bashku me rekomandimet përkatëse të cilat i vendos në dispozicion të njësive përgjegjëse. (Raporti mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve 2018-2019, dhe 2017-2018) Njësitë diskutojnë rekomandimet në mbledhjen e Rektoratit, ku vendoset dhe mbi masat për përmirësimin e cilësisë. Plani i masave miratohet nga Senati Akademik dhe vendoset në dispozicion</p>




	<p>të njësive nga Rektori.</p> <p>GVJ u njoh me procedurën dhe përmbajtjen e pyetësorit gjatë vizitës në institucion, ku veç të tjerash u njohëm nga NJSBC dhe Përgjegjësja e Departamentit se si mekanizëm monitorimi shërben dhe dokumentimi periodik i performancës akademike të pedagogëve, i cili pasqyron ngarkesën mësimore, veprimtarinë akademike, performancën në kërkim shkencor dhe shërbimet ndaj të tretëve. Pra, bëhet normimi i procesit të mësimdhënies dhe i punës Kërkimore - Shkencore të njësisë përmes formularit të performancës. Kjo e fundit raportohet në raportin vjetor të Departamentit të Biznesit. Një instrument tjetër që u evidentua në takimin me NJSBC ishte dhe tryeza e rumbullakët që zhvillohej me studentët Alumni nëpërmjet të cilës njësitë informohen se si të përmirësojnë më tej programet e studimit.</p> <p><i>(Raporti vjetor i DB 2018-2019)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në përputhje me Kriterin 2, UV prej dy vitesh ndjek një proces rigoroz të vlerësimit të mësimdhënies përmes anketimit të studentëve. Anketimi hartohet nga NJSBC dhe synon mbledhjen e opinionit të studentëve lidhur me procesin e mësimit dhe çdo dukuri tjetër të lidhur me të. Ky proces zhvillohet dy here në vit, në përfundim të semestrit dhe përpara sezonit të provimeve për të evituar ndikimin në vlerësim. Rezultatet janë pjesë e analizës vjetore të njësisë kryesore së bashku me formularin e performancës së stafit. GVJ në takimin me NJSBC u njoh me përmbajtjen e anketës prej 16 pyetjesh dhe rezultatet e anketimeve 2018-2019, dhe 2017-2018 të cilat janë publike në faqen zyrtare të UV-së.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) u vë në dispozicion vlerësimet drejtuesve të institucionit, drejtuesve të njësisë si edhe në mënyrë të personalizuar secilit pedagog. Siç u pohua nga takimi me NJSBC ato janë matësi kyesor i cilësisë së mësimdhënies në UV.</p> <p>Rezultatet e tyre diskutohen në mbledhjet e departamentit dhe shoqërohen me marrjen e masave korrigjuese.</p> <p>Gjithashtu, rezultatet e vlerësimit publikohen në faqen zyrtare të UV-së.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluar me NJSBC dhe Përgjegjësen e Programit u pohua se rezultatet e gjeneruara nga vlerësimet bëhen publike në mbledhjet e departamentit dhe promovohen shembujt e praktikave më të mira, ndërsa merren masa për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë jo vetëm të mësimdhënies, por dhe të kërkimit shkencor. Institucioni dhe</p>




	njësia përgjegjëse është e angazhuar në rritjen e angazhimit kërkimor të stafit, përmes rimbursimit të pjesëmarrjes në konferenca dhe publikimeve në revista shkencore; si dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies përmes ofrimit të mundësive të mobilitetit për mësimdhënie përmes programeve Mevlana dhe Erasmus + në Universitete Partnere.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Në programin e studimit Bachelor në Marketing, format kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksionet (1230 orë totale në auditor) - Seminarët (555 orë totale në auditor) <p>Projekte/Detyra Kursi janë pjesë e vlerësimit të lëndës.</p> <p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies përbën prioritet për njësinë (departamentin), dhe është reflektuar jo vetëm në dokumentat zyrtarë si Plani Strategjik i Programit të Studimit 2020-2024, por dhe në takimet e GVJ me përgjegjësen e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit. GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies duke siguruar mjete audio-vizive në orë të mësimi si projektor dhe kompjuter portabël, të cilat nuk gjendeshin të instaluar në auditorët e institucionit. Gjithashtu, pedagogët janë angazhuar për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimi, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimi të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gatishmërinë e pedagogëve për tu përgjigjur çdo pyetje e paqartësie të studentit. Edhe pse pajisjet audio-vizive nuk janë të disponueshme në çdo auditor, pedagogu së bashku me njësinë kujdeset ti sigurojë ato në avantazh të mësimdhënies bashkëkohore.</p>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e	Në përputhje me rregulloren mësimore, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore, programet dhe syllabuset

<p>mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>e lëndëve. Programi Bachelor në Marketing përfshin format e mësimi teorik e praktik si leksionet, seminarët, ushtrimet, detyrat e kursit. Mënyra kryesore e vlerësimit të dijeve është provimi final i modulit, ndërsa të tjera përfshijnë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, dhe provimi i formimit ose mbrojtja e diplomës.</p> <p>Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentë të programit u theksua se zhvillimi i orëve interaktive i lejon ata të përshihen më tepër dhe ndihmon mësimnxënien. Gjithashtu diskutimet dhe puna në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit nxisin të menduarit kritik. Për shkak të karakterit praktik të moduleve, përdorimi i rasteve reale të bizneseve për studim e bën më tërheqëse dhe aplikativ programin për studentët. Siç u theksua prej tyre, pedagogët janë të gatshëm të përgjigjen dhe asistojnë studentët për çdo paqartësi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>UV trajnon pedagogët e jashtëm e të brendshëm mbi specifikat e rregullores së UV, metodat didaktike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Pjesë e rëndësishme e trajnimeve është përdorimi i sistemit të brendshëm të komunikimit me studentët, për sigurimin e materialeve teorike dhe vlerësimet e studentëve.</p> <p>Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve. Përkatësisht nga takimi me studentët u pohua se në lëndën Shpërndarja dhe Menaxhimi i Forcës Shitëse, studentët patën mundësinë të flisnin me menaxherë të bizneseve të mëdha si metodë e re pedagogjike, në përputhje me objektivat formuese të lëndës dhe rritjen e kompetencave sipas kërkesave të punëdhënësve.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në funksion të moduleve aplikative, <i>UV ka në dispozicion vetëm një sallë kompjuterike të pajisur me programe kompjuterike bashkëkohore si SPSS, Financa 5 etj, ku studentët mund të mësojnë duke zgjidhur vetë raste e detyra praktike. Këto kapacitete edhe pse të limituara në vetëm 25 poste pune, përbëjnë një mundësi për transferimin e dijeve tek studentët.</i></p> <p>Në planin Strategjik 2018-2024 janë përcaktuar dhe kompetencat e reja didaktike për stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Biznesit, i angazhuar</p>

<p>shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>në programin e studimit Bachelor në Marketing përmbush të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. Stafi akademik mban gradën professor i asociuar dhe doktor në përputhje me ciklin e studimit ku japin mësim. Personeli akademik është i angazhuar në kërkim shkencor. Fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të personelit akademik, u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se departamenti i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Departamenti mbledhet periodikisht për të evidentuar arritjet dhe problematika që duhen përmirësuar.</p> <p>Për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies shërbejnë anketimet e studentëve dhe tryezat e rumbullakëta me ta, të cilat evidentojnë problematikat e mundshme lidhur me procesin mësimor. Sugjerimet nga ana e studentëve vlerësohen dhe reflektohen nga departamenti në përmirësim të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga takimi që GVJ realizoi me stafin akademik dhe studentët, evidentoi se mësimdhënia është interaktive duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në diskutim. Përdorimi i rasteve të studimit me tematika aktuale dhe integrimi i literaturës ndërkombëtare krijon interes dhe përfshirje të studentëve në zgjidhje analitike të rasteve të huaja dhe vendase. Materialet didaktike të përdorura përbëhen dhe nga materiale audivizuale të cilat krijojnë situata diskutimesh interaktive dhe nxisin punën në grupe të studentëve.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Metodat interaktive të mësimdhënies përqëndrohen tek mundësitë dhe interesat e studentëve. Personeli akademik i programit të studimit nxit studentët të ndërmmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në ngritjen e grupeve të punës, zgjedhjen e temave, përgatitjen e detyrave të kursit në të cilat vlerësohen dhe mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre, bashkëpunim në zgjidhjen e problemeve në seminare etj. Bashkëpunimi i ndërsjellë pedagog-studentë vihet re në auditor, në detyrat e ndryshme të kursit, në projekte e hartimin e diplomës dhe lehtësohet përmes sistemit të komunikimit me studentët dhe komunikimit elektronik zyrtar me adresat e mundësuar nga institucioni</p>




	(emër.mbiemër@univlora.edu.al).		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	
			✓


Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Procesi mësimor i programi Bachelor në Marketing zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë. Këto ambiente janë të ndara në dy godina kryesore: Godina A është e përbërë nga 2 kate, me 7 salla leksionesh dhe 14 salla seminaresh, dhe 5 laboratorë. Godina B është e përbërë nga 4 kate, me 8 salla leksionesh, 23 salla seminaresh dhe 2 laboratorë.</p> <p><i>GVJ kontatoi nga vizita në institucion se të dy godinat janë të ndara në salla, por asnjë prej tyre nuk disponon pajisje ngrohje dhe pajisjet audio vizive të nevojshme. Mungesa e ngrohjes në institucion përbënte shqetësimin kryesor dhe të studentëve.</i></p> <p>Gjithashtu studentët kishin në dispozicion bilbotekën e Fakultetit të Ekonomisë. <i>GVJ konstatoi se kishte mangësi në titujt bashkëkohor të literaturës të huaj e vendase, dhe pjesa më e madhe e titujve ishin të vjetëruar. Mungonte dixhitalizimi i arkivit të bibliotekës çka krijon vështirësi për studentët në kërkimin e literaturës. Gjithashtu, mungon biblioteka dixhitale për veprimtari kërkimore nga studentë e pedagogë.</i></p> <p>Institucioni ka mjedise të mjaftueshme për realizimin e programit mësimor. Staf i ndihmës mësimor i sektorit të shërbimeve mbështetëse ishte i angazhuar për mirëmbajtjen dhe sigurimin e pajisjeve ndihmëse në auditore, në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimin. Nga vizita në institucion u vu re se institucioni bën përpjekje për mirëmbajtjen e ambienteve dhe në ruajtjen e standarteve në ambientet e përbashkëta.</p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	<p><i>Nga vizita e realizuar në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë, konstatoam se mjediset ku zhvillohet mësimi nuk plotësojnë kriteret e nevojshme për zhvillim e mësimdhënies cilësore. Në këto mjedise vëzhguam salla leksione e seminare, laboratorë, salla mbledhesh, zyra e studio për zhvillimin e këtij programi studimi. Këto ambiente nuk janë të pajisura me kushtet optimale si ngrohja dhe me mjetet mësimore si kompjuter e video-</i></p>




	<p>projektor, tablo dhe dërrasë dixhitale të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme sipas VKM nr 418, date 10.05.2017, është 2.5 m² për student. Laboratorët mësimorë janë të pajisur me mjetet didaktike bazë për zhvillimin e detyrave mësimore. <i>GVJ rekomadon të përmirësohet logjistika e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>UV ka vendosur në dispozicion të studentëve një laborator të pajisur me 25 kompjutera ku janë instaluar të gjitha programet për realizimin e punës së pavarur nga studenti. Këto laboratorë janë pajisur dhe përmes projekteve ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë universiteti. Gjatë vizitës GVJ u njoh me Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Studentit, i cili ka lehtësuar veprimet me sekretarinë mësimore dhe gjithashtu ndihmon ndërveprimin e studentit me pedagogun dhe menaxhimin e informacionit mësimor.</p> <p><i>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe konstatimet tona nga vizita në institucion, GVJ gjykon se UV i nevojitet të përmirësojë infrastrukturën IT. GVJ rekomandon shtimin e laboratorëve në përputhje me numrin e studentëve dhe përmirësimin e infrastrukturës në auditore si dhe në bibliotekën e fakultetit. Të krijohet akses në bibliotekat elektronike si EBCSO, Emerald, Cambridge University, Questia. Gjithashtu, do të ishte risi ndërtimi i një laboratorit marketingu ku studentët të mund të zhvillojnë plane dhe fushata për bizneset lokale.</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë në modulet e këtij program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore që u ofrohet studentëve përfshin tekste mësimore, cikle leksione, leksione në ppt, materiale plotësuese.</p> <p>Nga shqyrtimit i Syllabuseve të lëndëve të programit bachelor në Marketing rezultoi se si literaturë bazë studentëve u ofrohen tekste të përkthyer nga titullarët e lëndëve në trajtën e cikleve të leksioneve.</p> <p>Nga vizita në bibliotekë rezultoi se një pjesë e titujve dhe teksteve mësimore nuk gjendeshin fizikisht, ndërsa titujt kryesorë në bibliotekë ishin të mbi 10 viteve të shkuara, pra dominon vitet 2003-2007.</p> <p><i>GVJ konstaton se mungon literatura bashkëkohore në gjuhën shqipe për programin, dhe sugjeron të pasurohet fondi i bibliotekës me titujt e përfshirë në kurrikulat mësimore të lëndëve. Të përzgjidhet me kujdes literatura bashkëkohore dhe të bëhet një përkthim profesional i titujve kryesorë në gjuhën</i></p>




	<i>shqipe. Të krijohet biblioteka dixhitale ku studenti mund të lexoj librat fizikë të bibliotekës kudo ku ndodhet dhe të sigurohet akses në bibliotekat elektronike si EBCSO, Emerald, Cambridge University, Questia.</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	<i>Fondi i bibliotekës në gjuhën shqipe dhe të huaj për modulet e programit Bachelor në Marketing është i vogël dhe një pjesë e teksteve mësimore të paraqitura në syllabuse nuk gjenden fizikisht në bibliotekë. Institucioni ende nuk ka kryer dixhitalizimin e bibliotekës, çka vështirëson kërkimin e librave të programit të studimit. Studentët dhe personeli akademik nuk mund të aksesojnë biblioteka dixhitale si: Sage, Ebsco të cilat ofrojnë mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se biblioteka nuk përdoret shumë nga studentët.</i>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	<i>Siç u përmend dhe më sipër personeli akademik dhe studentët nuk aksesojnë libraritë online pasi UV nuk disponon abonim. Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët rezultoi se studentët nuk kishin djeni për bibliotekë virtuale.</i>
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	<i>Fakulteti i Ekonomisë ka vënë në dispozicion të studentëve një laborator mësimor informatike të pajisur me 25 vende dhe programe bashkëkohore që u nevojiten për kryerjen e detyrave të kursit dhe diplomës. Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët GVJ konstatoi se laboratori shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</i>
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	<i>Ky kriter nuk aplikohet pasi UV nuk ka një sistem të mirëfilltë E-learning. UV ka në përdorim platformën UVMS (Sistemin e Menaxhimit të Informacionit) për administrim, dokumentim, ndjekje, raportim dhe shpërndarje të materialeve mësimore nga pedagogët për studentët. UVMS është i aksesueshëm online për të gjithë pedagogët dhe studentët. Nga takimi i GVJ me studentët ata pohuan se kishin një llogari të tyre personale, prej të cilës mund të marrin informacion për planin mësimor, orarin dhe vlerësimet e pedagogëve. Megjithëse përmes sistemit UVMS bëhet i mundur shkëmbimi i informacionit mes sekretarisë, pedagogut e studentit, ai mbetem një kanal statik komunikimi pa lehtësirat e një platforme të mirëfilltë E-learning.</i>
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe	<i>Komunikimi i brendshëm realizohet përmes adresave të Email-it të krijuara nga institucioni për stafin akademik, administrativ dhe studentët. Sic u përmend më sipër UV ka gjithashtu</i>

hapësirën vetjake të dedikuar.	sistemin e komunikimit UVMS. Përmes UVMS studentët mund të aksesojnë Syllabusin e Lëndëve, leksionet e lëndëve, materialet në funksion të realizimit të lëndës dhe detyrat dhe vlerësimet përkatëse. Sistemi ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues student apo pedagog. Studenti merr gjithë bazën didaktike për lëndën por nuk ndërvepron me kolegët e tjerë të kursit.								
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon programi i studimit dhe departamenti. Udhëheqësi i diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet për konsultime dhe realizimin e tij. Udhëheqësi zhvillon seanca metodologjike në auditor me grupin e studentëve që udhëheq, për të garantuar shkrimin e punimit në përputhje me standartet e punimit shkencor. Udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e paraqitur nga studentit përpara mbrojtjes.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>✓</td> <td></td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			✓	
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		✓							


Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, UV ka organizuar stuktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor- kërkimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standartet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit; - Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UV, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë; <p>Veprimtaria e NJSBC përfshin monitorimin e vazhdueshëm të institucionit në:</p> <p>Ndjekjen e vazhdueshme të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe</p>




	<p>përmirësimit të vazhdueshëm të performances;</p> <p>Ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij;</p> <p>Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij;</p> <p>Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion.</p> <p>Këto njësi ndjekin me përgjegjshmëri problemet që lidhen me mësimdhënien, vlerësimin institucional dhe zhvillimet mësimore në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Veprimtaria e tyre miratohet dhe rregullohet nga Senati i Universitetit.</p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Cilësia e procesit të mësimdhënies është në fokus të Departamentit të Biznesit dhe Fakultetit të Ekonomisë. Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit, të performancës akademike- mësimore, njësia bashkëpunon ngushtësisht me NJSBC-në për garantimin e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, të personelit akademik dhe të studentëve. Institucioni ofron mundësinë e trajnimeve dhe workshopeve të ndryshme të cilat orientojnë personelin akademik dhe personelin mësimor-shencor në përditësimin dhe kualifikimin e mëtejshëm profesional. Gjithashtu për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies, ndiqen si praktikë leksionet e dhëna nga lektorë të ftuar vendas, por dhe të huaj, pjesë e të cilëve janë dhe nga programi ERASMUS+. Të gjitha këto shkëmbime i shërbejnë rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe programit të studimit.</p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Pedagogët në Programin Bachelor Marketing, inkurajohen të zhvillojnë leksione me debate, diskutime brenda në klasë, punime individuale dhe në grupe. Personeli akademik bën të gjitha përpjekjet që studentët të kuptojnë konceptet dhe stimulon aplikimin e tyre praktik. Kjo e fundit u pohua dhe nga takimi që GVJ zhvilloi me studentët.</p> <p>Gjithashtu Institucioni ka miratuar Udhëzuesin për zhvillimin e metodave novative të mësimdhënies, për aplikimin e metodave të reja për kontrollin e shkallës së përvetësimit të lëndëve nga studentët. Në kuadër të rritjes së performancës mësimore dhe zhvillimit të metodave innovative kanë ndihmuar dhe specializimet</p>

	<p>e pedagogëve në Universitete Perëndimore, pjesë e shkëmbimeve Erasmus+.</p> <p><i>Nga vizita në Institucion GVJ konstatoi se infrastruktura IT mbetet pengesë për integrimin e metodave inovative në mësimdhënie.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në planin strategjik të UV, prioritet është kërkimi shkencor. Kërkimi shihet si faktor kyç në promovimin e insitucionit dhe programeve të studimit. Institucioni ka zhvilluar Qendrën Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillim Rajonar për kualifikime në fushën e kërkimit shkencor. UV u ofron personelit akademik mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme përmes projekteve kërkimore me partnerë të huaj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe dosjeve personale të pedagogëve vihet re se personeli i angazhuar në këtë program është aktiv në publikimin e artikujve dhe materialeve shkencore në fushat që përfshihen në programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Departamenti i Biznesit realizon leksione me pjesëmarrjen e pedagogëve apo specialistve të mirënjohur të fushës së marketingut, me synim marrjen e përvojës metodologjike dhe pedagogjike nga personeli akademik. Në dy vitet e fundit kanë pasur të ftuar staf akademik të huaj që kanë sjellë përvojën e mësimdhënies në UV dhe personeli akademik i UV ka marrë përvojë ndërkombëtare në mësimdhënie në universitete perëndimore përmes programit Erasmus+.</p> <p><i>GVJ rekomandon se njësia bazë duhet të angazhohet në ofrim të qëndrueshëm të trainimeve dhe workshopeve për personelin akademik në bashkëpunim me Qendrën Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillim Rajonar si mjet motivues për stafin akademik për zhvillimin e metodave e praktikave të reja të mësimdhënies, dixhitalizimin dhe përmirësimin e aftësive kërkimore. Gjithashtu, nga takimi i zhvilluar me stafin akademik rezultoi se nuk ka grupe kërkimore të ngritura në department, çka është një mundësi për zhvillimin e trainimin e tyre.</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën Ndihmëse të Shërbimit monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor. Institucioni ofron trajnime ndërkombëtare në kuadër të programit Erasmus+ për stafin akademik dhe personelin ndihmës akademik për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja nëpërmjet praktikës së leksioneve të hapura nga pedagogë të ftuar.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe</p>	<p>Institucioni ka realizuar zhvillimin e disa aktiviteteve me natyrë shkencore të tilla si konferenca, seminare, leksione të hapura me lektorë të ftuar, ku është nxitur pjesëmarrja e</p>




raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	personelit akademik. Metodatat e reja janë diskutuar nga stafi akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit dhe aplikuar tek studentët. NJSBC analizon efektet e pritshmëritë e studentëve dhe i raporton në mënyrë periodike për rezultatet Përgjegjësit të Departamentit, i cili rishikon metodatat e mësimdhënies me stafin akademik.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet		
			✓

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Bazuar në rregulloren e UV, rregulloren e programit Bachelor në Marketing kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet dy rubrikave: vlerësimi i vazhduar (përfshin aktivizimin në seminare, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit) dhe vlerësimi në provim përfundimtar. Raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me raportin përfundimtar përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të çdo semestri.</p> <p>Në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive. Syllabusi ngarkohet në sistemin UVMS nga ku mund të aksesohet lehtësisht nga studentët. Gjithashtu, GVJ konstatoi se në webfaqen e UV-së gjenden të publikuara rregulloret e institucionit dhe programit të studimit.</p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Format e kontrollit të dijeve gjenden në rregulloren e UV, dhe u bëhen të ditur studentëve me anë të programit e syllabusit të lëndës, që në javën e parë të fillimit të mësimin nga pedagogu i lëndës. Studentët e programit të studimit mund të informohen edhe në distancë përmes sistemit UVMS në lidhje me lëndët, përmbajtjen e tyre dhe metodologjinë e vlerësimit të njohurive.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi e vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale realizohet në forma të ndryshme si: pjesmarrja aktive; plotësimi i detyrimeve (detyrave të kursit); testimet gjatë vitit; provimi përfundimtar.

	Vlerësimi i studentit ndahet në vlerësim i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, si dhe vlerësimi përfundimtar. Duke shqyrtuar Syllabuset e lëndëve rezultoi se raporti është në masën 40% (provimi përfundimtar) dhe 60% vlerësimi i vazhduar gjatë vitit (aktivizimi, detyra kursi, testime). Kjo formë inkurajon angazhimin aktiv të studentëve gjatë kursit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushje tërësisht		
			✓

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Vlerësimi gjatë vitit inkurajon angazhim dhe ndërveprim të studentit dhe e përgatit atë për sezonin e provimeve. Sic u përmend dhe në standartin III.5 raporti i vlerësimit të vazhduar gjatë vitit me raportin përfundimtar përcaktohet nga pedagogu i lëndës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit në fillim të çdo semestri. Vlerësimi gjatë vitit dhe vlerësimi përfundimtar gjenden në formë elektronike përmes sistemit UVMS. Gjithashtu rezultatet e studentit dokumentohen në dokumenta si regjistri dhe pasqyra e vlerësimit dhe depozitohen në Sekretarinë Mësimore.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UV i kushton shumë rëndësi transparencës dhe privatësisë së vlerësimit. Vendosija e rezultateve në sistemin elektronik UVMS, lejon secilin student të shikojë vetëm vlerësimin e tij dhe askush tjetër nuk ka akses për të parë vlerësimet e tjetrit. Gjithashtu vlerësimi bëhet në kohë. <i>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se UV nuk përdor format e vlerësimit në mënyrë elektronike (si p.sh nëpërmjet Clean Score, një nga format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve). Kjo do të reduktonte abuzimin dhe subjektivitetin e vlerësimit të studentëve. Gjithashtu, u konstatua se provimet nuk sekretoreshin në korrigjim nga pedagogët. Kjo është një procedurë me vlerë për rritjen e transparencës së vlerësimit nga pedagogu.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Referuar Rregullores së ciklit të parë të studimit Bachelor në Marketing dhe RVB, komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Në rastin e mbrojtjes së Diplomës, realizohet me komision me pesë anëtarë. Vlerësimi i diplomës është kusht për




	<p>përmbushjen e detyrimeve lidhur me kreditet e programit dhe me diplomimin.</p> <p>Komisionet përcaktohen nga Përgjegjësi i Departamenti në përputhje me Rregulloren në fuqi.</p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të Studimit dhe vizita në Institucion u vu re se format e testimit me shkrim si të vazhduar ashtu dhe përfundimtare nuk zhvillohen duke mbajtur anonim emrin e studentit, nëpërmjet procesit të sekretimit. Referuar Nenit 61 të Rregullores, rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi, kontrolli i dijes përcaktohet nga titullari i lëndës, i cili është përgjegjës për hartimin e tezës së provimit dhe është plotësisht përgjegjës për ruajtjen e sigurisë së vlerësimit pa asnjë kontroll survejimi institucional. Pas përfundimit të provimit, rezultatet evidentohen në Sistemin UVMS jo më larg se 48 orë nga dita e zhvillimit të tij. Editimi i rezultateve bëhet në përputhje me Nenin 89 të rregullores dhe në rast mos krytje të tyre konsiderohen shkelje akademike dhe merren masa disiplinore nga njësia kundrejt pedagogut të lëndës.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të UV-së, u njoh me dokumentacionin dhe procedurën e vlerësimit të dijeve. Në fund të çdo provimi, testet dorëzohen në sekretari të mbyllura në zarf e të firmosura nga lektori dhe ruhen deri në fund të semestrit pasardhës.</p> <p><i>GVJ rekomandon që testimi e vlerësimi i dijeve me shkrim në UV të zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim.</i></p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi me studentët GVJ u informua se pedagogu i lëndës i orienton studentët mbi të gjithë elementët e vlerësimit të dijeve. Në vazhdim ata udhëzohen mbi zhvillimin e detyrave të kursit dhe rasteve studimore. Gjatë zhvillimit të tyre dhe në mbrojtjen e tyre studentët marrin këshilla dhe vlerësim nga pedagogu lidhur me aspektet pozitive dhe negative dhe çfarë duhet të përmirësojnë. Ky proces ndihmon studentët të përmirësohen në aspekte të mësimnxënies dhe të ballafaqimit me audiencën.</p> <p>Gjithashtu, sipas RVB vlerësimi i dijeve në provim shoqërohet</p>

	<p>me komente sa herë pedagogu e gjykon të nevojshme. Pas provimit, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Pas kësaj seance pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve në sekratinë mësimore siç udhëzon Rregullorja e UV-së.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Rregullat e zhvillimit të kontrolleve të dijës përcaktohen në Rregulloren e UV-së dhe Kodin e Etikës së UV-së, ku janë të specifikuar qartë dhe penalitetet për rastet e konstatimit të kopjimit ose plagjiaturës.</p> <p>Gjatë zhvillimit të provimit ndalohet hyrja e personave të jashtëm me përjashtim të pedagogëve të autorizuar për mbikqyrje. Studenti lejohet të paraqitet në provim vetëm pasi ka një mjet identifikimi si karta e studentit ose kartë identiteti. Gjatë provimit ndalohet celulari dhe personi që përdor mjete të tilla të palejueshme përjashtohet nga provimi.</p> <p><i>Lidhur me plagjiaturën në detyra kursi, apo tema diplome, ajo nuk mund të evidentohet pasi në institucion mungon një program specifik për këtë qëllim.</i></p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing; Kodi i Etikës)</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e programit, vlerësimi i kontrollit të dijeve bëhet me pikë, të cilat më pas konvetohen në notë. Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me nota nga 1-10, ku 10 është vlerësimi maksimal ndërsa nota kaluese është 5. Përmes sistemit online UVMS, studenti informohet brenda afateve të përcaktuara nga neni 61 i rregullores së UV-së për rezultatet e provimit. Hedhja në sistem e rezultateve të vlerësimit të vazhduar të lëndës bëhet përpara dates së zhvillimit të provimit përfundimtar. Studentët njihen me notën përfundimtare pas zhvillimit të provimit sipas rregullores së institucionit dhe programit të studimit në fuqi.</p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka dokumentacion të plotë që siguron garantimin e të drejtave të studentëve për tu njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloren dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Ne Nenin 62 të rregullores së UV-së, dhe Nenin 11 të programit të studimit është pasqyruar ankimimi për rezultatin përfundimtar të provimit dhe procedura për rishikimin e</p>




	<p>vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të kërkojnë rishikim të vlerësimit brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit. Përgjegjësi i Departamentit me miratim të Dekanit ngre komisionin ad-hoc për përcaktimin e vlerësimit përfundimtar të studentit.</p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>								
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas Nenin 62 të rregullores së universitetit dhe Nenit 11 të rregullores së programit të studimit, studenti ka të drejtë të ankimojë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës. Ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision ad-hoc, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Vlerësimi i Komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar.</p> <p>Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës si dhe vendimi i marrë dokumentohet dhe arkivohet. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në një procesverbal të ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkëlidhet atij të mëparshmit si dhe pasqyrohet në sistemin elektronik UVMS.</p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1361 730 1429"></th> <th data-bbox="730 1361 963 1429"></th> <th data-bbox="963 1361 1189 1429">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1189 1361 1370 1429">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1429 730 1498"></td> <td data-bbox="730 1429 963 1498"></td> <td data-bbox="963 1429 1189 1498" style="text-align: center;">✓</td> <td data-bbox="1189 1429 1370 1498"></td> </tr> </tbody> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			✓	
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		✓							

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Marketing, pjesë e Departamentit të Biznesit, është hapur me VKM Nr. 270, datë 10.06.2011 me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (UMASH). Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë Bachelor në “Marketing” e regjistruar me Vendim Nr. 439, datë 09.09.2011 nga Ministria e Arsimit</p>




	<p>dhe Shkencës. Programi ka pësuar ndryshime me Vendim Senati Nr. 58, datë 06.09.2018 në masën 20% në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Këto ndryshime janë miratuar nga MASR me shkresë Nr. 10761/1, datë 25.10.2018.</p> <p>Programi i studimit realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra).</p> <p>Lidhur me përmbajtjen e programit të studimit, përbëhet nga (5) lëndë bazë, (15) lëndë të formimit karakterizues (4) lëndë ndërdisiplinore, (5) lëndë plotësuese dhe Diploma.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Marketing garanton formimin dhe kualifikim e studentëve në fushën e marketingut duke siguruar njohuritë themelore në shkencën e marketingut që të jetë i krahasueshëm me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për profilin e programit dhe për të ndjekur ciklet e tjera të thelluara të studimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron një rishikim të lëndëve të formimit karakterizues, duke theksuar se lëndët e profilit marketing duhet të garantojnë përfundimin e dijeve dhe kompetencave aktuale te profilit. Për këtë nevojitet të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së lëndëve si Marketing Dixhital, Komunikimi i Integruar Marketing, Inovacion. Ka një përsëritje të lëndëve karakterizuese Strategji Marketing dhe Marketing Strategjik, ndaj GVJ sugjeron të shikohet mundësia e integritit të tyre ose zhvillimit të lëndës Planifikim Marketing me aplikim praktik në biznese. Gjithashtu, si nevojë e shprehur dhe nga studentët për zhvillim të aftësive profesionale, do të ishte mire integrimi i praktikës mësimore në semestrin e fundit me qëllim prezantimin e studentëve në tregun e punës.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron të pasurohet literatura bazë e detyruar me tekste bashkëkohore në gjuhën shqipe.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në Syllabuset e çdo lënde janë përcaktuar kompetencat specifike që fitojnë studentët sipas modulit përkatës të programit të studimit. Kurriklua e programit bachelor në marketing i jep mundësi studentëve të zhvillojnë aftësi të veçanta përveç atyre të profilit marketing në fushën e</p>

	<p>teknologjisë së informacionit, të komunikimit dhe ndërveprimit përmes moduleve plotësuese si Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Shkrim Akademik.</p> <p><i>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rekomandon thellimin e kopetencave ndërdisiplinore në Sociologji, Psikologji të nevojshme dhe për profilizimin në marketing.</i></p> <p><i>Gjithashtu nga takimi me studentët u konstatua se ishin të pakta aktivitetet ndërdisiplinore në institucion si organizime sportive apo kulturore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e studimit paraqiten në syllabuset e çdo lënde. Vlerësimi dhe analizimi i tyre bëhet në bazë të statistikave të rezultateve të anketimit të studentëve, diskutimeve me studentët dhe vlerësimeve përfundimtare të lëndës të cilat analizohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mëtejshme në përputhje me qëllimet e programit të studimit.</p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në javën e fundit të semestrit pedagogët realizojnë një seance konsultuese ku orientojnë studentët në lidhje me çështjet ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, struktura e përgjithshme e tezës dhe udhëzime të tjera lidhur me natyrën e pyetjeve që do të përfshihen në provimin përfundimtar.</p> <p><i>(Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në përcjelljen e informacionit mbi zhvillimet e reja të shkencës kanë shërbyer leksionet e hapura me të ftuar nga industria dhe pedagogët e huaj të ardhur përmes programeve të shkëmbimit Erasmus+. Nga njësia përgjegjëse e programit të studimit planifikohen orët e hapura dhe diskutimet mbi zhvillimet aktuale të ekonomisë e biznesit.</p> <p><i>(Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Pas dhënies së informacionit teorik, studentët testohen ti aplikojnë ato në praktikë duke punuar në grupe pune, tre ose kater studentë, puna e të cilëve materializohet në detyrë kursi, rast studimi, stimulim i zgjidhjes së një problem biznesi.</p> <p><i>GVJ thekson domosdoshmërinë e konkretizimit të teorisë në praktikë për të gjitha modulet e programit të studimit. Mbi</i></p>

	<p>të gjitha lëndët e profileve duhet të konkretizojnë njohuritë e specializuara të profilit me raste praktike.</p> <p>Gjithashtu, ofrimi i praktikës profesionale do tu shërbente studentëve si faze reflektimi mbi kompetencat e fituara dhe qasjen ndaj zgjidhjeve të problemeve praktike.</p> <p><i>(Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>		
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	<p>Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët sipas grupeve të punës në lidhje me realizimin e detyrës së caktuar dhe stimulon zgjidhjen e një problemi biznesi. Në këtë proces personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat të cilat kanë nevojë për thellim teorik dhe studim të mëtejshëm. UV e ka pjesë të strategjisë kërkimore përfshirjen e studentëve në kërkime shkencore. Sipas RVB studentët kanë qënë pjesëmarrës aktiv në konferencën shkencore të Marketing -Turizëm e organizuar nga Departamenti i Biznesit.</p> <p>Gjithashtu studentët kanë mundësi të angazhohen në zyrën e Marketingut të Universitetit, ku inkurajohen për zhvillimin e ideve inovative në promovimin e UV-së në kuadër dhe të bashkëpunimeve Erasmus+.</p> <p><i>GVJ thekson rëndësinë e mbështetjes financiare të studentëve për nxitjen e novacionit dhe kërkimit shkencor.</i></p>		
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>Në kuadër të strategjisë të ndërkombëtarizimit të Universitetit, është forcuar bashkëpunimi me Universitete partnere si pjesë e programit Erasmus+. Për shkak të ngjashmërisë së kurrikulave, eksperiencën që personeli akademik ka marrë gjatë mobiliteteve në instancat partnere e ka aplikuar në përmirësimin e formave të mësimdhënies dhe rritjen e mobiliteteve të studentëve.</p> <p><i>(Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2016-2020)</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		✓	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve****Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të

Bazuar në rregulloren e programit të studimit Neni 14 dhe




<p>posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>15, përshkruhet zhvillimi i procesit të diplomimit të studentëve të programit Bachelor në Marketing. Për t'u diplomuar studenti duhet t'i nënshtrohet një provimi të përgjithshëm formimi, ose të mbrojë një punim diplome, i cili të lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit dhe është një punim i pavarur shkencor i studentit. Departamenti përcakton kriteret dhe standartet e hartimit të një punimi diplome dhe informon studentët për procedurat dhe kriteret e punimit të diplomës.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Personeli akademik orienton studentët në zgjedhjen e temës sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti. Gjithashtu udhëzon studentët me seanca metodologjike dhe sipas një kalendarit takimesh duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme. Udhëheqësi i punimit të diplomës planifikon një kalendar komunikimi me studentin dhe përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet kohore të realizimit të tij. <i>(Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Ne vend të punimit të diplomës, studenti ka të drejtë të zhvillojë një provim të përgjithshëm formimi, ku atij do ti duhet të aplikojë njohuritë kryesore të përfituara gjatë tre viteve të studimit për t'i dhënë përgjigje pyetjeve me gojë. Kjo procedurë ashtu si dhe mbrojtja e diplomës përcaktohet në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Marketing. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final/diplomës përbëhet nga 5 anëtarë dhe propozohet nga Përgjegjësi i Departamentit e miratohet nga Dekani.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Studenti propozon Profesorin udhëheqës pasi ka marrë dhe aprovimin e tij. Departamenti shqyrton propozimet e studentëve dhe temën dhe garanton që udhëheqësi të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit miraton listën e temave dhe udhëheqësve shkencor. Studentët njoftohen për listën e miratuar me temat dhe pedagogët udhëheqës. Gjatë seancave orientuese me pedagogun studentet asistohen për përcaktimin e temave të diplomës dhe udhëzime të tjera mbi përmbajtjen e saj. Në rastin e provimit të diplomës, udhëzimet dhe materialet e nevojshme, përfshi bankën e pyetjeve i vendosen në dispozicion studentit nga Departamenti i Biznesit. <i>(Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët kanë në dispozicion infrastrukturën e UV-së me laboratorin kompjuterik e bibliotekën për konkretizimin e punimit të tyre. Gjithashtu, sipas RVB institucioni mundëson</p>

	akses në statistika të qarkut të Vlorës. Pedagogu udhëheqës asiston studentët deri në përfundim të dorëzimit të diplomës.		
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Nga bisedat me përgjegjësen e departamentit dhe studentët gjatë vizitës në institucion, u konstatua se pedagogët udhëheqës të temave të diplomave, asistonin studentët si për sigurimin e literaturës dhe përpunimin e të dhënave. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer dhe lejon mbrojtjen e tij duke e firmosur atë. Studenti dorëzon kopjen e firmosur të punimit të diplomës në Departament.		
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas Rregullores së Programit të Studimit, mbrojtja e diplomës ose provimi i formimit bëhet me gojë dhe studenti vlerësohet me notë sipas komisionit të vlerësimit për mbrojtjen e diplomave Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë dhe vlerësimi është unanim, por i bazuar dhe në vlerësimin e udhëheqësit. Mesatarja e vlerësimeve të anëtarëve të komisionit të provimit konvertohet në note.		
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Sipas Rregullores së Programit studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit. Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuar nga MAS. <i>(Diplomë e programit të studimit Bachelor; Suplementi i Diplomës së programit të studimit Bachelor)</i>		
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti i programit Bachelor në Marketing pajiset me diplomën, suplementin e diplomës, listën e notave dhe sipas kërkesës nga një kopje të syllabuseve për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit.		
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Dokumentacioni i studentëve ruhet nga UV për një periudhë të pacaktuar që nga koha e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretaries mësimore ku verifikoi dosje të studentit, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		✓	




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Analiza e RVB, dokumentave shoqëruese (organigrana, statute, analiza vjetore) si edhe diskutimet me personelin drejtues të departamentit dhe fakultetit siguruan informacion të mjaftueshëm për të gjykuar se institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat mbi personelin e angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Sipas organigramës (http://univlora.edu.al), Vendimit të Senatit Akademik Nr.8 datë 14.02.2018 (Evidenca 3.2) dhe Rregullores së UV (Evidenca C), sektori i Protokoll Arkivës dhe Burimeve Njerëzore është struktura përgjegjëse për mbledhjen e informacionit. Edhe verifikimi faktik i dosjeve në strukturën e sipërpërmendur dëshmoi pasurinë dhe saktësinë e informacionit.</p> <p>Spektori i Protokoll Arkivës dhe Burimeve Njerëzore disponon dosje individuale për secilin pedagog të angazhuar në procesin akademik. Këto dosje përditësohen në bazë të ndryshimit të arritjeve akademike të pedagogëve (grada shkencore, artikuj të botuar, prezantime në konferenca, etj).</p> <p>Raportimi i të dhënave mbi personelin akademik si edhe angazhimi i përgjithshëm i çdo anëtari të personelit gjatë vitit akademik dhe sipas semestrave, së bashku me angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ, është objekt përshkrimi dhe analize gjatë përgatitjes të Raportit Vjetor (Evidenca 1.5).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Departamenti i Biznesit është struktura përgjegjëse për vlerësimin e nevojave për personel akademik, si edhe paraqitjen e nevojave tek sektori i Burimeve Njerëzore. Departamenti paraqit nevojat përpara fillimit të çdo viti akademik, në përputhje me Planin Mësimor (Evidenca 4.1.)</p> <p>Nevojat paraqiten të detajuara, sipas disiplinave akademike që duhet të mbulohen, si edhe sipas nivelit të kualifikimit të kërkuar. Departamenti i kushton vëmendje respektimit të legjislacionit në fuqi, në lidhje me kërkesat dhe kriteret për angazhimin e personelit akademik (Evidenca C, “Rregullore e UV”, Evidenca A, “Statuti”).</p> <p>UV ka hartuar dhe miratuar një procedurë standarte punësimi (Evidenca 4.2) për rekrutimin e personelit akademik, për zbatimin e së cilës ngarkohet Seksioni i Burimeve Njerëzore</p>





	<p>(në përputhje me statutin, Evidenca A) në bashkëpunim me Departamentin (roli i departamentit u përshkrua më lart).</p> <p>GVJ shqyrtoi në mënyrë të detajuar një procedure punësimi, të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme dhe konkludoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” është zbatuar me përpikmëri; • Statuti I UV dhe Rregullorja janë respektuar gjithshashtu; • Nevojat e Departamentit janë konsideruar dhe plotësuar; • Procedura e rekrutimit është zbatuar. <p>Megjithatë, nisur nga fakti që tregu i punës në Vlorë nuk ofron shumë mundësi zgjedhje sepse konkurenca është e kufizuar në raport me kërkesat për personel akademik të shkallës së lartë të kualifikimit, Profesorë dhe Doktorë, <i>GVJ sugjeroi që departamenti mund të ngushtojë listën e kërkesave (duke respektuar kufijtë e përcaktuar nga legjislacioni) me qëllim që të ketë më shumë mundësi për të vëzhguar dhe vlerësuar nëpërmjet intervistës, një numër më të madh kandidatësh.</i></p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në vijim të argumentimit të paraqitur tek kriteri 2, konstatohet se Departamenti në rregulloren e tij (Evidenca 2.5) ka specifikuar kriteret e posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat përpiqet që t'i zbatojë me përpikmëri. Mbizotërimi i pedagogëve efektivë përkundrejt atyre me kohë të pjeshme, si edhe mbizotërimi i pedagogëve me gradën Doktor dhe Profesor përkundrejt Asistent lektorëve, është treguesi më domethënës mbi plotësimin e kriterit dhe standartit të kërkuar.</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha hapat e procedurës së rekrutimit si edhe dokumentacioni mbështetës janë transparent, të disponueshme në faqen e UV.</p> <p>Rastet e ankesave (tepër të fragmentuara) gjithashtu ndiqen me profesionalizëm dhe transparence, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 1525 735 1592"></th> <th data-bbox="735 1525 959 1592"></th> <th data-bbox="959 1525 1182 1592">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1182 1525 1359 1592">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1592 735 1637"></td> <td data-bbox="735 1592 959 1637"></td> <td data-bbox="959 1592 1182 1637"></td> <td data-bbox="1182 1592 1359 1637" style="text-align: center;">✓</td> </tr> </tbody> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për</p>	<p>UV, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Biznesit (Evidenca 1.1) në Planin Strategjik të Zhvillimit, 2018-2024</p>




<p>kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>kanë përcaktuar instrumentat strategjikë, të cilët do të mundësojnë arritjen e misionit të institucionit, ndër të cilat krijimi i mjedisit dhe mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit, është konsideruar i rëndësishëm parësor.</p> <p>Dokumentat thelbësorë udhëheqës të institucionit, përkatësisht Statuti, Strategjia, Rregullorja e UV, Rregullorja e Departamentit, shprehet garancia për lirinë akademike të pedagogut dhe investimi për të arritur cilësinë më të lartë të procesit akademik.</p> <p>Institucioni është angazhuar për krijimin e infrastrukturës së përshtatshme dhe të nevojshme për të mbështetur arritjen e objektivave akademike në një mjedis nxitës, bashkëpunues dhe zhvillues për studentët dhe stafin (Evidenca 2.10).</p> <p>Çdo anëtar i stafit është i paisur me kompjuter, ndërsa infrastruktura e sallave të leksioneve dhe seminareve lejon përdorimin e projektorëve. GVJ konstatoi se për arsye sigurie, projektorët nuk ishin të instaluar në mënyrë të palëvizshme, por secilit pedagog i duhej të montonte projektorin përpara fillimit të mësimt.</p> <p>Institucioni gjithashtu anagazhohet për vlerësimin e drejtë të stafit akademik, duke bazuar veprimtarinë në matjen e performances (Evidenca 3.3.).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni trajton me përparësi dhe është tërësisht i angazhuar që të mbështesë kualifikimin e vazhdueshëm profesional të personelit, nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore e shkencore individuale dhe në grup, në sajë të pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta, të financuara nga institucione ndërkombëtare ose bashkëpunime bilaterale. Institucioni mbështet financiarisht pjesëmarrjen e stafit akademik në këto aktivitete. Strategjia e Ndërkombëtarizimit (Evidenca D) si edhe Strategjia për Kërkimin Shkencor (http://univlora.edu.al/strategjia) sigurojnë informacion të mjaftueshëm dhe të larmishëm në mbështetje të evidencave mbi zhvillimin profesional të personelit akademik.</p> <p>Vendimi i Senatit Akademik Nr.32 datë 27.06.2018 miraton “Strategjinë për Trajnimin e Vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj”, në bazë të së cilit institucioni organizon aktivitete të vazhdueshme dhe cilësore, me synim rritjen e kapaciteteve akademike dhe profesionale të tij.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në zbatim të "Planit Strategjik, 2018-2024" (Evidenca 1.1), UV me Vendim Nr.1, date 13.01.2020, (Evidenca N) ka hartuar udhëzuesin mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, në vijim të ndjekjes së synimit të konsolidimit të institucionit si një institucion aktiv në transmetimin e dijes, ideve krijuese dhe nxitjen e praktikave të mira në vend. Këtij qëllimi i shërben edhe përpjekja e vazhdueshme e institucionit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të metodave bashkëkohore në përputhje me standartet ndërkombëtare, të përcaktuara edhe në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit.</p> <p>Megjithatë, <i>GVJ konstatoi se diskutimet në institucion nuk siguruan evidencë shtesë mbi planin e masave për zbatimin e Udhëzuesit të mësipëm, të materializuara në projekte konkrete për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni dëshmon angazhim maksimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të ciklit të parë në Marketing. Siç rezulton nga analiza e orarit të mësimit, ngarkesës mësimore si edhe planifikimit të kohës vjetore të punës për personelin akademik (Evidenca 4.1) rezulton se mesatarisht secili pedagog mbulon 6 lëndë në vit, përkatësisht 3 lëndë në semestrin e parë dhe po kaq në semestrin e dytë.</p> <p>Ndonëse norma e ngarkesës mësimore është në përputhje me VKM, ndërmjet kufijve 340 orë në vit ose 11 orë në javë deri në 450 orë, ose 15 orë në javë, për secilin pedagog, <i>GVJ gjykon që kjo ngarkesë, edhe pse nga stafi akademik gjykohet e pranueshme dhe e përballueshme, lë shumë pak hapësirë për aktivitetet kërkimor shkencor si edhe plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja në projekte kërkimore e shkencore.</i></p> <p>Çështja e ngarkesës mësimore për secilin pedagog u diskutua gjerësisht dhe thellësisht me personelin akademik, cili argumentoi se ngarkesa ishte plotësisht e përballueshme, për shkak të ekspertizës së lartë të personelit (80% e personelit janë me gradën Doktor dhe Profesor i Asociuar) si edhe për shkak të ngjashmërisë së lëndëve që mbulon një pedagog. Sidoqoftë, GVJ gjykon që komenti i mësimëprëm është i vlefshëm.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>




standardit		✓		
------------	--	---	--	--

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka siguruar një godinë të veçantë për Fakultetin e Ekonomisë me infrastrukturë të qëndrueshme për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe administrative, në funksion dhe të programit Bachelor në Marketing.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë i UV, pavarësisht burimeve relativisht të kufizuara financiare nga buxheti publik, siguron mjediset e mjaftueshme infrastrukturore dhe të përshtatshme. Informacioni i siguruar nga Evidenca 2.10. "Kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore", mbështet përfundimin se kapacitetet infrastrukturore prej 2.360m² të përdorura në dy turne për 1.694 studentë ose 2.78m² për një student, është mëse e përshtatshme, bazuar në standartin 2.5m² të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore janë të paisura me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Gjithashtu mjediset lejojnë instalimin e paisjeve elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, ndërsa çdo anëtar i stafit është i paisur me kompjuter.</p> <p>Gjithsesi, GVJ konstatoi se për arsye sigurie, projektorët nuk ishin të instaluar në mënyrë palëvizshme, por secilit pedagog iduhej të montonte projektorin përpara fillimit të mësimin.</p> <p><i>GVJ tërheq vëmendjen për përmirësimin e kushteve fizike të institucionit dhe pajisjen e auditoreve me ngrohje, dhe pajisje didaktike dixhitale si kompjuter e projektor.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratori i Fakultetit të Ekonomisë, në përdorim nga të gjithë studentët, përfshirë edhe ata që studjojnë Marketing, është i paisur me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, sinjal internet pa ndërprerje dhe pa pagesë, të cilat mbështesin realizimin e procesit mësimor sipas kërkesave dhe standartit të cilësisë. Laboratori gjithashtu krijon kushtet e përshtatshme për përdorimin e</p>

	<p>metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimit dhe mësimit.</p> <p><i>Pavarësisht çfarë u vlerësua më lart, GVJ tërheq vëmendjen për nevojën e shtimit të laboratorëve të kompjuterave për studentët pasi i vetmi laborator që shërben të gjithë fakultetin ka një kapacitet prej vetëm 25 poste pune.</i></p> <p>Mjediset në të cilat zhvillohet aktiviteti akademik kanë nevojë për përmirësim në mënyrë që aktiviteti akademik e shkencor të zhvillohet në standartin e nevojshëm.</p>								
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Edhe nga argumentat e paraqitur në kriterin 3, rezulton se institucioni e plotëson kriterin e sigurimit të së paku një laboratorit.								
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Vizita në institucion mbështet përfundimin se ambientet e Fakultetit të Ekonomi së, të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në dispozicion të realizimit të procesit mësimor për studentët të cilët ndjekin studimet në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Marketing, janë mjediset të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e këtij procesi mësimor.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>✓</td> <td></td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			✓	
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		✓							

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjediset mbështetëse të mësimit, bibliotekën, mjediset të posaçme të mësimit dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimit për studentët e programit të studimit

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.

Sipas "Informacioni i sektorit të bibliotekës", shkresa Nr.37/3 Prot, datë 10/01/2020, në përgjigje të kërkesës së Rektorit, date 08/01/2020, Nr.37/1 Prot, rezulton se në dispozicion të studentëve të Fakultetit Ekonomik, institucioni, ka siguruar njërin nga 3 bibliotekat, bibliotekën qendrore të Godinës A (Rektoratit), me 3 salla leximi dhe 2 specialistë në shërbim të studentëve.

Hapësirat e mjaftueshme dhe shërbimi cilësor garantojnë mundësitë e shfrytëzimit të studentëve të literaturës në gjuhën shqipe dhe të huaj.

Biblioteka A është e hapur prej orës 08.00 deri në 20.00,





	<p>duke rritur mundësitë e përdorimit dhe të përfitimit për studentët.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ tërheq vëmëndjen për faktin se literature si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhë të huaj duhet të rí-freskohet me botime bashkëkohore.</i></p> <p>Rinovimi i bibliotekës me titujt bashkëkohorë si dhe rinovimi i aksesit në revistat shkencore online, të cilat për momentin nuk ishin të aksesueshme duhet të jetë në vëmëndje të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p><i>Të dhënat e shqyrtuara (Evidenca 3.9) si edhe informacionet e siguruar nga vizita në institucion treguan se biblioteka është e pasur me literature bazë si tekste mësimore bazë, literature ndihmëse, revista shkencore apo libra të tjerë, të cilët, ndonëse në aspektin sasior mund të krijojnë idenë e plotësimit të nevojave dhe mbulimit të kërkesave të disiplinave shkencore dhe veprimtarive mësimore, nga pikëpamja cilësore nuk e plotësojnë këtë nevojë, sepse pjesa më e madhe e teksteve mësimor i përkasin viteve të para të tranzicionit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka (Evidenca 3.9) në dispozicion të studentëve të Fakultetit Ekonomik mundëson plotësimin e kërkesave të të gjithë studentëve, nga pikëpamja e kapaciteteve sasiore: biblioteka me sipërfaqe 252m² ofron 60 poste, me një koeficient shfrytëzimi 67%. Arkiva gjithashtu është vendosur në këtë sallë. Studentëve iu është garantuar akses i barabartë dhe pa pagesë.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, saktësisht vizitës në bibliotekë dhe takimit me punonjësit e saj, u konfirmua se institucioni, i ndërgjegjshëm për rëndësinë e kompjuterizimit të bibliotekës, ka marrë vendimin për dixhitalizimin e saj, vendim i cili i hap rrugën investimeve për përmirësimin cilësor të aksesit të studentëve tek literatura.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës. Institucioni (Evidenca 3.9) përdor çdo burim të mundshëm financiar për të pasuruar dhe përmirësuar cilësinë e titujve të bibliotekës, përfshirë buxhetin publik si edhe burimet nga të tretë: projekte ose donacione. Megjithatë, të dhënat dëshmojnë se burimi themelor i blerjeve mbetet buxheti i institucionit, i financuar nga shteti.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në</p>	<p>Institucioni ka marrë masat për të rritur efektivitetin e shërbimit në bibliotekë, e cila është e hapur në orarin nga 8.00 deri 20.00.</p>




përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				✓

Standardi IV.5
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Në zbatim të Ligjit nr.80/2015, për Arsimin e Lartë, si edhe në përputhje me Statutin dhe rregulloren e UV dhe të Departamentit, Sekretaria mësimore është struktura e ngarkuar për mbajtjen e të gjitha të dhënave të studentëve, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar, • Regjistrin e arritjeve, • Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. <p>Të dhënat mbi studentët janë të plota, të qarta, të sakta dhe të arkivuara me kujdes. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë systemin që lidhet me të dhënat mbi studentët, përgjatë të gjithë periudhës së qëndrimit në institucion, deri në largimin e tyre, për shkak të diplomimit ose të transferimit.</p> <p>Në shërbim të studentëve është platforma dixhitale UVMS, të cilën studentët e aksesojnë që në momentin e aplikimit në UV (http://uvms.univlora.edu.al)</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Platforma UVMS ende nuk përfshin systemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit mbi aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, administrative dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Ky informacion menaxhohet nga seksioni i Protokoll Arkivës dhe Burimeve Njerëzore.</p> <p>Pavarësisht faktit se ky informacion nuk është ende pjesë e sistemit të dixhitalizuar, informacioni menaxhohet dhe administrohet me kujdes e përpikmëri nga sistemi i brendshëm, sipas përcaktimit në statut dhe rregullore.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe</p>	<p>Mbështetur në diskutimet e zhvilluara në institucion, GVJ konfirmon se nëpërmjet UVMS, i gjithë personeli, nëpërmjet</p>




studentët e programit të studimit.	fjalëkalimit individual të miratuar nga struktura që ka përgjegjësinë e mirëmbajtjes së sistemit, siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente, në përputhje me nevojën, si për mbarëvajtjen e procesit akademik, ashtu edhe për realizimin e detyrimeve administrative.		
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	GVJ, gjatë diskutimeve në institucion, me stafin akademik, sekretarinë si edhe studentët, gjykon që sistemi i menaxhimit UVMS ofron disa përparësi, nga të cilat më thelbësorja është sigurimi i aksesit të shpejtë dhe të sigurtë tek materiali shkencor, leksionet dhe literature, në sajë të të cilave studentët realizojnë objektivat e tyre akademike. UVMS është formë efektive e komunikimit dhe e shkëmbimit të informacionit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve, përfshirë edhe informacionin që lidhet me rezultatet e vlerësimit të studentëve nga pedagogët, por ajo nuk zëvendëson komunikimin aktiv dhe interaktiv në klasë.		
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Një tjetër përparësi e sistemit UVMS është mundësimi i monitorimit dhe raportimeve individuale në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UV ka një faqe web të dedikuar, në të cilën publikohet çdo informacion. Faqja mirëmbahet nga seksioni IT i UV dhe siguron informacion të përditësuar, në dy gjuhë, shqip dhe anglisht (https://univlora.edu.al/en/programet-e-studimit-bachelor).		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			✓

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Hartimi i raportit financiar është përgjegjësi e strukturës përkatëse në nivel universiteti, ndërsa detyrimet e departamentit janë të kufizuara, kryesisht vetëm për paraqitjen e kërkesave të argumentuara për aktivitete të ndryshme të lidhura me procesin akademik si edhe kërkimin shkencor. Pavarësisht kësaj, raporti financiar është pjesë e Raportit Vjetor (Tabela 18 dhe Evidenca I, J). Nga të dhënat e tabelës 18 rezulton se burimet e vetme të




	<p>financimit janë: buxheti i shtetit dhe të ardhurat nga tarifrat e studimeve.</p> <p><i>GVJ konstaton se me të dhënat e disponuara nuk mund të krijohet një ide e plotë dhe e qartë e kostove si edhe e shkallës të mbulimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e Institucionit dhe të Departamentit, GVJ konstaton se Njësia bazë nuk harton plan financimi, sepse plani i financimit hartohet në nivel universiteti dhe jo sipas programeve të veçanta. Kjo ka të bëjë me faktin se Institucioni kërkon të sigurojë financimin si të programeve me numër të lartë të studentëve, siç është “Biznesi”, ashtu edhe të programeve me numër të ulët të studentëve.</p> <p>Sidoqoftë, në kushtet e mungesës të burimeve të treta të financimit, institucioni mund të planifikojë vetëm brenda kornizës të buxheteve të alokuara apo të garantuara (pagesat e studimeve nga studentët).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifrat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni i nënshtrohet auditimit të jashtëm (nga Kontrolli i Lartë i Shtetit) si edhe atij të brendshëm, nga Njësia e Auditimit, e krijuar në vitin 2019, në zbatim të Vendimit të Senatit si edhe si kërkesë e legjislacionit në fuqi.</p> <p>GVJ konstatoi se në dosjen e vetëvlerësimit nuk rezulton që institucioni të ketë paraqitur një raport auditimi apo raport të detajuar financiar.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Megjithëse raportet financiare të institucionit dokumentohen sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet në fushën e finances, kjo nuk është përgjegjësi e departamentit.</p> <p>Pavarësisht kësaj, çështjet financiare janë objekt diskutimi edhe në departament, me qëllim rritjen e mundësive për mbështetjen e cilësisë së programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>UV është institucion publik, i financuar nga buxheti i shtetit, për rrjedhojë qëndrueshmëria financiare e tij, është e garantuar. Nga ana tjetër, rritja absolute e buxhetit, dëshmon për vëmendjen që i kushtohet mbarëvajtjes së procesit akademik dhe plotësimit të kërkesave të tregut të arsimit të lartë.</p> <p><i>Sidoqoftë, një analizë e detajuar e raporteve e shpenzimeve si edhe shkalla e lidhjes së tyre dhe e ndikimit tek procesi mësimor, do të shërbente për të plotësuar kuadrin e</i></p>




	<i>vlerësimin, si edhe planifikimit strategjik të veprimtarisë së institucionit në afatgjatë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			✓

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV			Përmbushet kryesisht
			✓

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UV ka hartuar dhe vënë në zbatim politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë ciklin e parë të studimeve universitare në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programi i studimit ka përcaktuar objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale e analitike. Kriteret e pranimit të studentëve përcaktohen nga MASR në përputhje me udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore për vitin akademik përkatës. <i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Rregullorja e Programit të studimit përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit dhe deri në përfundim të studimeve apo transferimit të tyre, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve dhe studentëve të programit. <i>(Rregullore Programi i Studimit Bachelor Marketing)</i> <i>(Rregullore e UV)</i>
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimin të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimin të dijeve dhe të diplomimit përcaktohen qartë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e UV.

	Ky informacion bëhet publik nëpërmjet faqes zyrtare të UV dhe është lehtësisht i aksesueshëm. <i>(Rregullore Programi i Studimit Bachelor Marketing)</i>		
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve Bachelor përcaktohen nga MASR për vitin akademik përkatës dhe publikohen nga institucioni në fillim të çdo viti akademik. Sipas rregullores së programit të studimit, pranimi në programet e studimit të ciklit të parë bëhet i mundur për ata që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional, si dhe kandidatët që disponojnë diplomën e shkollës së mesme jashtë vendit (të ekuivalentuar nga MAS). <i>(Rregullore Programi i Studimit Bachelor Marketing)</i> <i>(Rregullore e UV)</i>		
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Shtetasit shqiptarë, shqipëtarët jashtë kufijve shtetërorë, si dhe shtetasit e huaj kanë të drejtën të ndjekin studimet vetëm nëse përmbushin kriteret e përcaktuara nga MASR, statuti i UV dhe rregulloret përkatëse në lidhje me studimet e ciklit të parë. <i>(Rregullore Programi i Studimit Bachelor Marketing)</i> <i>(Rregullore e UV)</i>		
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik, UV udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit përmes websitit të tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët potencialë. Nga vizita në insitucion GVJ u njoh me planin e aktivitete të informimit të maturantëve të hartuar nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit përpara fillimit të vitit akademik.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht ✓

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**



<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Informacion i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin paraqitet qartë në rregulloren e UV si dhe atë të programit të studimit. Ky informacion vihet në dispozicion nga Zyra e Pranimeve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Sekretaria Mesimore e Institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UV informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme nëpërmjet Sekretarisë Mësimore, Zyrës së Këshillimit të Karrierës, dhe departamentit përkatës të programit të studimit. Kriteret dhe procedurat e transferimit përcaktohen në Rregulloren e insitucionit dhe të programit të studimit dhe bëhen publike përmes faqes web të UV-së si dhe vihen në dispozicion të studentëve përmes sistemit informativ UVMS.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>UV informon studentët lidhur me vlerësimin e dijeve nëpërmjet Rregullores së Programit të studimit ku paraqiten:</p> <p>Sistemi i vlerësimit; forma e vlerësimit; forma e kontrollit të dijeve; kushtet për hyrjen në provim; organizimin e provimeve; shpalljen e rezultateve; ankimimin dhe rishikimin e notës.</p> <p>Në Syllabusin e secilës lëndë ka informacion të detajuar lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve. Studentët e aksesojnë informacion dhe në distance përmes sistemit UVMS dhe fizikisht pranë sekretarisë së departamentit të programit të studimit. Në fillim të çdo semestri, syllabusi dhe kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve shpjegohen nga pedagogu i lëndës përkatëse.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>UV u vendos në dispozicion studenëve udhëzues të shkruar mbi kriteret e procedurat e punimit të diplomës. Gjithashtu siç u sqarua ne seksionin III gjatë periudhes së përgatitjes të punimit te diplomes zhvillohen seancat metodologjike dhe pedagogu udhëheq studentët për punim e diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës së institucion, GVJ u informua se në fillim të çdo viti të ri akademik, UV zhvillon “Javën e Orientimit”, nëpërmjet të cilës studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambientet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Gjithashtu faqja zyrtare online dhe rrjetet sociale japin informacion për të interesuarit mbi programet e studimit.</p> <p><i>Megjithatë GVJ rekomandon më shumë përpjekje nga</i></p>




	<i>institucioni në drejtim të marketimit të programit të studimit Bachelor në Marketing, me qëllim rritjen e kërkesës dhe forcimin e programit të studimit në të ardhmen.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		
			✓

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Departamenti i Biznesit informon studentët në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, nëpërmjet rregullore së programit të studimit. Ky informacion vendoset në dispozicion të studentëve në websitin e UV dhe u lejon studentëve pët të marrë informacion lidhur me organizimin e plotë të studimeve të këtij programi. Gjithashtu, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Bachelor në Marketing nga sekretaria mësimore dhe pedagogët, si dhe informacioni publikohet në sistemin UVMS ku çdo student është i regjistruar.</p> <p><i>(Rregullore Programi i Studimit Bachelor Marketing)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Studentët marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me procesin mësimor etj. Këto informacione dhe dokumenta merren në zyrën e sekretarisë dhe gjenden në version elektronik në sistemin UVMS, dhe në websitin e institucionit. Gjithashtu në fillim të secilit semestër studentët pajisen me të gjithë syllabuset e lëndëve nga pedagogët.</p> <p><i>(Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>Zyra e Karrierës në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Studentit, informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet ata në mënyrë institucionale për ti orientuar në tregun e punës. Aktivitetet e punësimit të studentëve përfshijnë Panaire pune - UV open days; Biznese te ftuar ne auditor; Aktivitete Alumni, dhe bashkëpunime me organizma lokale. Institucioni përmes dy zyrave përgjegjëse inkurajon studentët të marrin pjesë dhe informon ata mbi</p>




	zhvillimet në tregun e punës. (Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)						
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët kanë mundësi të aksesojnë informacion të plotë mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij përmes sekretarisë mësimore dhe njësisë bazë, por edhe online nëpërmjet UVMS ku pedagogë e student shkëmbejnë materiale lidhur me lëndën dhe programin e studimit. (Rregullore e UV-së; Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)						
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	GVJ konfirmon se informacioni rreth ecuresë së programit, detyrimeve akademike për të përmbushur programin, afateve kohore në funksion të përmbushjes së programit, monitorohen nga një sistem menaxhimi e informimi i brendshëm. UV disponon një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit (UVMS) dhe është i arritshëm nga studentët jo vetëm në ambientet e institucionit por edhe në distance përmes llogarive të tyre personale. Informacioni në lidhje me procesin mësimor është lehtësisht i disponueshëm përmes sistemit të brendshëm. (Rregullore e Programit Bachelor në Marketing)						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>✓</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			✓
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		✓					

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.

Në analizën mësimore të departamentit të Biznesit gjenden të pasqyruara statistikat vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar në programin Bachelor Marketing. UV disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor ne Marketing, të konstatuara në sekretarinë e njësisë në formë elektornike dhe fizike përmes regjistrave të lëshimit të diplomave. Nëpërmjet Zyrës Alumni, po bëhen përpjekje për sigurimin e kontakteve me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave




	<p>efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës.</p> <p>Sipas <i>Raportit vjetor të UV-së – Cilësia në hyrje e në dalje të studentëve dhe vizitës së GVJ në sekretarinë mësimore</i> u konstatua se numri i studentëve në këtë program studimi në tre vitet akademike ishte:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 : 5 studentë</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 : 17 studentë</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018 : 24 studentë</p> <p>Për vitin akademik 2016-2017 : 33 studentë</p> <p>Për sa i përket numrit të të diplomuarve në këtë program studimi rezulton se:</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar gjithsej 21 studentë;</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018 janë diplomuar gjithsej 29 studentë;</p> <p>Për vitin akademik 2016-2017 janë diplomuar gjithsej 28 studentë;</p> <p><i>GVJ konstatoi se numri i studentëve ka ardhur duke u ulur në mënyrë të ndjeshme dhe njësia duhet të angazhohet në evidentimin e analizimin e studentëve ndër vite në bashkëpunim me zyrën Alumni në funksion të strategjisë së përforcimit të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>UV disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit në përputhje me Statutin e UV-së. Për programin Bachelor në Marketing rezultojnë 3 studentë të transferuar përkatësisht 2 në vitin akademik 2018-2019 dhe 1 në vitin akademik 2017-2018. GVJ evidentoi se statistikat e studentëve disponohen në formë elektronike dhe fizike në sekretarinë e departamentit.</p> <p><i>(Statuti i UV-së)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit të brendshëm UVMS institucioni ruan të dhënat personale të studentëve. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave kryen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e brendshme të UV.</p> <p>I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në sistem</p>




	dhe aksesohet vetëm përmes studentit sipas numrit të matriculimit të tij. Sistemi mban të dhëna për prezencën, vlerësimin dhe stadin ku ndodhet një student me programin që ndjek. (Statuti i UV-së)								
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit UVMS, një program informatik i cili administron dhe përpunon të dhënat e studentëve nga sekretaria, drejtuesit dhe personat e autorizuar në kohë reale. Çdo e dhënë për cdo student është e garantuar të mbrohet, dhe kanë akses vetëm persona të autorizuar. (Statuti i UV-së)								
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti i Biznesit harton raportin vjetor të analizës mësimore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe punësimin e tyre. Departamenti reflekton mbi gjendjen aktuale dhe bazuar në këto të dhëna propozon masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. GVJ shqyrtoi Raportin Vjetor 2018-2019 të UV-së ku evidentohen dhe pikat e dobëta të cilat kërkojnë përmirësim për vitin pasardhës. (Raportin Vjetor 2018-2019)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>✓</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Studentët kanë mbështetjen e UV-së për tu angazhuar në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Nga takimi me studenët u informuam se ata organizohen në Këshill Studentor në nivel Fakulteti dhe në grupe diskutimi për vlerësimin e procesit mësimor dhe dhënien e ideve për përmirësim të vazhdueshme në përputhje me nevojat e tyre. Gjithashtu, studentët janë pjesë aktive e procesit të anketimit për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në secilën lëndë.




	Sipas Statutit të UV-së dhe RBV-së ata kanë përfaqësues në Senatën Akademik.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konfirmon se pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje është e natyrshme aspak e sforcuar dhe fiktive. UV garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe në këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik. Studentët organizohen në Këshill Studentor ku shprehin mendimin e tyre për problematika të ndryshme lidhur me çështje të programeve mësimore dhe procesit mësimor. Gjithashtu NJSBC organizon periodikisht takime me studentët, përmes të cilave mendimet dhe propozimet e studentëve u paraqiten departamentit dhe merren masat përkatëse korrigjuese. Nga takimi me studentët mësuam se ata janë në djeni të këtyre stukturave dhe i mbështesin ato.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Programi i studimit është organizuar duke marrë në konsideratë aftësinë e studentëve për të përvetësuar njohuritë. Në vlerësimin e ngarkesës akademike janë mbajtur në konsideratë si marrja e informacionit teorik ashtu dhe atij praktik përmes detyrave dhe projekteve të kursit. Vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të shpërndarë gjatë semestrit në raportin 60:40. Kjo formë vlerësimi inkurajon angazhimin e studentëve gjatë gjithë kursit. Nga takimi i zhvilluar me studentët ata u shprehën të kënaqur lidhur me përmbajtjen dhe ngarkesën e programit të studimit, përveç se pohuan mungesën e praktikës së punës. Departamenti është bashkëpunues me studentët për të lehtësuar praktikën e njohjes së lëndëve dhe ka procedurë joburokratike të njohjes së studimeve të mëparshme.
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Studentët në mënyrë indirekte përfshihen në rishikimin e syllabuseve apo të programit Bachelor në Marketing. Kjo për faktin se studentët angazhohen në vlerësimin e performancës së pedagogëve dhe në dobinë e disiplinës akademike përmes anketimeve semestrale nga NJSBC. <i>(Referuar Rregullores së Programit dhe detyrimit që kanë studentët të përfshihen në plotësimin e pyetësoreve)</i>
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët përmes anketimeve të realizuara nga institucioni mund të japin mendimin e tyre mbi kryerjen e procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve Gjithashtu, nga vizita në institucion u informuam se pas çdo provimi pedagogu vendos seanca sqaruese në të cilat studentët kuptojnë dhe komunikojnë me pedagogun përkatës lidhur me vlerësimin dhe mundësinë për rishikim të vlerësimit.
Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet Përfundohet

standardit	kruesit	ditën
		✓

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Disa nga njësitë e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë Departamenti, ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimit, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësues; Sekretaria Mësimore ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi; Zyra e Karrierës ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit. UV ka krijuar procedurë në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me rregullatoren e institucionit. <i>(Statuti i UV-së dhe Rregullore e UV-së)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësues dhe programin e studimit.	UV ka një sistem online për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësues dhe programin e studimit. UVMS ofron informacione të përditësuara për procesin mësues dhe programin e studimit. Baza e të dhënave për studentin përfshin edhe emailin si një mjet për informim nga sekretaria dhe pedagogët. Gjithashtu ka ngritur zyrën e Shërbimit ndaj Studentëve për asistimin e tyre në çështje që kanë të bëjnë me procesin mësues dhe programin e studimit. <i>(Statuti i UV-së dhe Rregullore e UV-së)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësues, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstaton se në UV funksionon Zyra e Karrierës dhe Alumni, e cila luan rol në këshillimin dhe orientimin e studentëve në tregun e punës. Përmes panairëve të organizuara, projekteve bashkëpunuese me biznesin, bordin e Alumni, UV shkëmben informacion lidhur me njohuritë dhe aftësitë që ofron programi i studimit dhe profilet në tregun e punës. <i>Nga takimi i zhvilluar me studentët, GVJ konstatoi gjithashtu se ata nuk kishin djeni për zyrën e Karrierës dhe nuk kishin patur kontakt me ta. Ndaj, GVJ rekomandon angazhim më të lartë të këtij sektori ndaj studentëve të programit Bachelor në Marketing.</i>




<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra për Këshillimin e Karrierës dhe Alumni ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve. Nga takimi i zhvilluar me njësinë e karrierës dhe Alumni, GVJ u njoh me vështirësitë në gjurmimin e të diplomuarve të programit Bachelor në Marketing. Në këtë kontekst, GVJ rekomandon një bashkëpunim më të mirë të kësaj zyre me departamentin dhe personelin akademik me qëllim rritjen e performancës së saj, krijimin e Bordit Alumni, dhe vendosjen e marrëdhënieve bashkëpunimi mes UV-së e tregut të punës. Kjo të mundësonte një kontribut më të madh të Zyrës së Karrierës në drejtim të studentëve të programit të studimit Bachelor në Marketing.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		✓	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		✓	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p>Standardi VI.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UV ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke përmbushur kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Shqipëri si edhe kërkesat e përcaktuara në aktet rregullatore të brendshme institucionale si Statuti (Evidenca A), Rregullorja e Institucionit (Evidenca 2.5).</p> <p>Statuti i UV, Kreu VIII, neni 80, 81 dhe 82 përcaktojnë parimet e përgjithshme mbi të cilat organizohet sistemi i sigurimit të cilësisë, mekanizmat që përdoren për të garantuar cilësinë si edhe përbërjen e strukturës përkatëse.</p> <p>Në përputhje dhe në zbatim të nenit 80, sigurimi i brendshëm i cilësisë mund të jetë i përgjithshëm ose i pjesshëm. Për garantimin e tij, institucioni ka krijuar</p>

	<p>Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Evidenca 3.1).</p> <p>NJSBC u krijua në vitin 2016 në përputhje me Vendimin e Senatit Nr. 82 (Evidenca 3.1) dhe u riorganizua si sektor i pavarur në vitin 2018, sipas Vendimit të Senatit Nr.8. Ky sektor përbëhet nga 3 punonjës, personel ndihmësakademik me karakter administrativ (1 përgjegjës dhe 2 specialistë) nën varësinë e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve.</p> <p>Institucioni, me vendim të Senatit ka krijuar edhe Komisionet e Përhershme të Cilësisë në nivel institucioni dhe në nivel Njësie Kryesore (Fakulteti)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në institucion funksionon Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, i cili zbaton një strategji institucionale (Evidenca 3.5), instrumentat themelorë të së cilës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetsori i studentëve, që përbëhet nga 14 pyetje të mbyllura dhe dy të hapura. Të dhënat e pyetsorit mblidhen dhe analizohen. Analiza bëhet në dy nivele: si mesatare aritmetike si edhe për çdo lëndë e pedagog (Evidenca K dhe L). Raporti i analizës së pyetsorëve është publik (https://univlora.edu.al). Pyetsori është në process rivlerësimi dhe përmirësimi (Evidenca 3.4, evidence 3.10 dhe Evidenca 6.1), 90% e studentëve marrin pjesë në vlerësim. Raporti plotësohet çdo fund viti akademik. • Tryeza e përbashkët me aktorë të tregut të punës, në të cilat janë punësuar studentë të UV. Kjo praktikë, e konsideruar si praktikë e mirë, është përdorur për here të pare në vitin 2019 si instrument i vlerësimit të cilësisë. Operatorët e tregut të punës siguruan opinionet e tyre në lidhje me studentët e UV. • Sondazhi Kombëtar i Studentëve me objekt vlerësimin e institucionit. <p>GVJ gjykon që politika e vlerësimit të cilësisë jo vetëm që është ndërtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, por i shërben me efektivitet institucionit për të garantuar cilësinë e procesit akademik. Ajo realizohet nga institucioni në bashkëpunim me studentët si edhe grupet e tjera të interesit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë</p>	<p>Në shtesë të instrumentave të përdorura nga NJSBC, departamentet përdorin instrumenta të tjerë si formulari</p>




<p>realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>performancës të pedagogëve dhe komisionet e përhershme që monitorojnë cilësinë e mësimdhënies (Evidenca 3.3.).</p> <p>Departamenti analizon rezultatet e të dhënave dhe diskuton në mbledhjen e departamentit.</p> <p>Sidoqoftë, <i>GVJ gjykon që procesi i vlerësimit të cilësisë përballet me disa vështirësi, nga të cilat infrastruktura fizike e pamjaftueshme si edhe kualifikimi i pamjaftueshëm i stafit të NjsBC, ndikojnë në efektivitetin e masave të marra nga institucioni në drejtim të përmirësimit të cilësisë.</i></p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar procedura të qarta dhe të detajuara, të cilat I ndjek me përpikmëri. Këto procedura knaë ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit të stafit akademik, të drejtuesve të departamenteve, të studentëve dhe të bashkëpunëtorëve të institucionit, të cilët mbështesin NjsBC në zbatimin e Planit të masave për garantimin e cilësisë.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>✓</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				✓
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			✓						

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Për garantimin e cilësisë, institucioni ka krijuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Evidenca 3.1) si edhe me vendim të Senatit ka krijuar edhe Komisionet e Përhershme të Cilësisë në nivel institucioni dhe në nivel Njësie Kryesore (Fakulteti)</p> <p>Departamenti është njësia bazë që ka të drejtën dhe profesionalizmin e përmirësimit, ndryshimit apo propozimit të kurrikulave. Stafi i departamentit, përballë tregut të punës, literaturave bashkëkohore, studentëve, biznesit, nevojës për përmirësim/ndryshim dhe përmirësim të vazhduar është gjithnjë në kërkim të mënyrave të përmirësimit, rregullimeve në kurrikula, përshtatje të tyre, përmirësimit të syllabuseve të veçanta, etj;</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>Evidencat 3.1, 3.3, 3.5, 3.10, 6.1, K dhe L si edhe diskutimet me strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e</p>




<p>herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>cilësisë në institucion, konfirmojnë gjetjen se institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, të cilat janë hartuar në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe atë rregullator të institucionit.</p> <p>Në qendër të garantimit të cilësisë është studenti, dijet dhe njohuritë e tij si edhe shkalla e përthithjes së tyre me qëllim ri-përdorimin me efikasitet në tregun e punës. Për rrjedhojë, Departamenti në çdo veprim apo inisiativë që ka lidhje me procesin akademik, udhëhiqet nga opinionet dhe propozimet e studentëve, të cilat ata i shprehin përgjatë procedurave të vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar Evidencave 3.3, 3.4 dhe 3.5, konkludohet se institucioni përdor metodologji vlerësimi, në të cilën përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i procesit të mësimdhënies nga instancat drejtuese; • Vlerësimi i procesit të mësimdhënies nga përgjegjësi i Departamentit; • Vlerësimi nga studentët, sipas një pyetsori me format të caktuar dhe të strukturuar (u shpjegua tek pika VI.1, kriteri 2); • Vlerësimi i punës kërkimore shkencore të stafit; • Përfshirja e studentëve në diskutimet mbi tematika të ndryshme; <p>Përveç procedurave të vlerësimit, departamenti realizon edhe procedurën e analizës, raportimit dhe marrjes së masave, me qëllim vënien në jetë të rekomandimeve të vlerësimit, të cilat synojnë rritjen e cilësisë të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>Gjithsesi, GVJ sugjeron që metodologjia e vlerësimit duhet të jetë e unifikuar, ndërsa instrumentat, mostra e studimit dhe cilësitë e saj, duhet të miratohen në departament.</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Diskusimet me punonjëset e sektorit përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë konfirmuan se dokumentimi i rezultateve është pjesë e procedurave. Gjithashtu, këto rezultate, jo vetëm dokumentohen tek sektori i burimeve njerëzore, por edhe raportohen tek përgjegjësat e departamenteve, të cilët informojnë stafin dhe marrin masat përkatëse..</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e</p>	<p>Pavarësisht të gjitha shpjegimeve të dhëna në pikat e mësipërme dhe që rikonfirmojnë përfundimin se</p>




vlerësimin dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	departamenti përpiqet që të përdorë me efektivitet rezultatet e vlerësimeve, <i>GVJ gjykon që departamenti nuk ka evidenca që të dëshmojnë se si kanë ndikuar rekomandimet e dhëna dhe masat e ndërmarra për garantimin e cilësisë së procesit akademik.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet Kryesisht	Përmbushet Në tërësi
		✓	

Standardi VI.3 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i brendshëm i programit është proces që kryhet periodikisht, nga NjSBC në nivel institucional, kalon në disa etapa dhe është institucionalizuar përmes metodologjisë së përdorur. Institucioni e përfshin këtë informacion në procesin e vetëvlerësimit në kuadër të akreditimit periodik. Departamenti, në procesin e Vlerësimit të Brendshëm, të realizuar si pjesë e akreditimit periodik të Programit Bachelor në Marketing, ka përgatitur RVB i cili shërben si instrument për të përcaktuar drejtimit e përmirësimit të cilësisë. Çështjet e RVB janë përfshirë edhe në raportin Vjetor, 2018-2019. Ky programi akreditohet për here të parë.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Institucioni përdor metoda dhe instrumenta, në përputhje me objektin e studimit si edhe cilësitë specifike të fushës akademike. Pyetsori i studentëve është instrumenti themelor, i cili përpunohet sipas metodologjisë të analizës sasiore të të dhënave, çdo vit akademik. Risi e institucionit në këtë proces, rezultoi konsultimi me operatorët e tregut të punës, instrument të cilin, departamenti e konsideron si praktikë të mire, e për rrjedhojë synon që ta përfshijë në metodologjinë e vlerësimit. Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç

	<p>në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me NJSBC.</p> <p>Strukturat drejtuese, Rektorati dhe Senati, kanë përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet nga Grupi ad-hoc i vlerësimit të brendshëm, i cili ka ndjekur procedurat bazuar në ligj dhe akte nënligjore si dhe në kuadrin rregullator të institucionit.</p> <p>GVB ka ndërtuar raportin e vlerësimit të brendshëm bazuar mbi specifikat e institucionit.</p> <p><i>GJV gjykon që grupi vlerësimit të brendshëm e ka përbulluar me profesionalizëm sfidën e eksperiencës së parë të procesit të akreditimit. Gjithsesi, sigurimi i kurseve të formimit dhe rritja e kualifikimit, do të jetë proces i dobishëm për rritjen e cilësisë së procesit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Referuar Evidencave 3.3, 3.4 dhe 3.5, konkludohet se institucioni përdor metodologji vlerësimi të drejtpërdrejta, në të cilën përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i procesit të mësimdhënies nga instancat drejtuese; • Vlerësimi i procesit të mësimdhënies nga përgjegjësi i Departamentit; • Vlerësimi i Brendshëm. • Vlerësimi nga KSBS <p>Objekt i këtyre vlerësimeve janë: Procesi akademik dhe mbarëvajtja e tij, përfshirja e studentëve në aktivitetet formuese dhe jashtë kurrikulare, kualifikimi dhe motivimi i stafit akademik, kërkimi shkencor dhe ecuria e tij, pjesëmarrja në projekte dhe rezultatet e tyre, rezultatet akademike të studentëve si edhe mirëfunksionimi i procedurave ankimore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ,</p>	<p>Referuar Evidencave 3.3, 3.4 dhe 3.5, konkludohet se institucioni përdor metodologji vlerësimi të tërthorta, në të cilën përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi nga studentët, sipas një pyetsori me format të caktuar dhe të strukturuar;

<p>punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i punës kërkimore shkencore të stafit; • Përfshirja e studentëve në diskutimet mbi tematika të ndryshme; • Përfshirja e operatorëve të tregut të punës. <p><i>GVJ gjykon që përfshirja në procesin e vlerësimit të cilësisë i "Alumni" do të ishte një instrument tejet i dobishëm dhe me vlerë, sepse do të sillte mendimin dhe rekomandimet studentëve të diplomuar, në periudha të ndryshme dhe të karrierave të ndryshme. Por institucioni ende nuk ka arritur të finalizojë listën e "Alumni" dhe të përdorë atë për qëllimin e mësipërm.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="614 741 774 808">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="774 741 986 808">Përmbushet plotësisht</td> <td data-bbox="986 741 1198 808">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1198 741 1359 808">Nuk përmbushet</td> </tr> <tr> <td data-bbox="614 808 774 855"></td> <td data-bbox="774 808 986 855"></td> <td data-bbox="986 808 1198 855" style="text-align: center;">✓</td> <td data-bbox="1198 808 1359 855"></td> </tr> </table>	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Nuk përmbushet			✓	
Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Nuk përmbushet						
		✓							

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kritëret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Stafi i NJSBC është i ndërgjegjshëm për mangësitë në ekspertizë, pavarësisht pjesëmarrjes në kualifikimet e ofruara nga ASCAL. Për rrjedhojë, NJSBC, pavarësisht përpjekjeve për të unifikuar procedurën e vlerësimit të cilësisë dhe përdorimin e të dhënave të saj me efektivitet, duhet të mbështetet me qëllim që të aftësohet për të ndërtuar politika afatgjata që garantojnë cilësinë dhe qëndrueshmërinë.</p> <p><i>GVJ gjykon dhe sugjeron që institucioni duhet të përfshijë aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të përherëshëm, që përfaqësojnë grupe të rëndësishme interesi, për të tashmen dhe të ardhmen e institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të brendshëm, i përbërë nga dy pedagogë dhe një studente, ka përcaktuar përgjegjësitë për secilin anëtar, ndonëse i gjithë aktiviteti i vlerësimit të brendshëm është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me departamentin.</p> <p>Pavarësisht kësaj, i gjithë procesi ka qenë tepër i vështirë për shkak të mungesës së eksperiencës, volumit të dokumentacionit, nevojës për të mbledhur të gjitha të</p>




	<p>dhënat e nevojshme si edhe nevojës për të njohur mirë legjislacionin si atë kombëtar, ashtu edhe rregulloret e brendshme.</p> <p><i>GVJ gjykon dhe konkludon që institucioni duhet të hartojë procedure standarte për realizimin e Vlerësimit të Brendshëm si edhe duhet të ndërmarrë inisiativa që nxisin kualifikimin e burimeve të brendshme të institucionit në drejtim të zbatimit të procedurave të vlerësimit të brendshëm.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në zbatim të Statutit të UV, Kreu VIII, neni 80, 81 dhe 82, si edhe sipas diskutimeve në institucion, nësia bazë dhe kryesore përfshihen në vlerësimin e cilësisë, duke qenë baza e zbatimit të procesit si në aktivitetet e përditshme ashtu edhe në aktivitete periodike, të raportimeve, mbledhjeve etj. Përmes tyre përfshihen anëtarët e personelit akademik.</p> <p>Studentët e programit përfshihen përmes vlerësimeve periodike dhe plotësimit të pyetësorëve. Garancia për përfshirjen e këtyre aktorëve jepet përmes dokumentave bazë, statuti, rregullorja, rregullorja e programit të studimit, dhe vendimet për marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në zbatim të Statutit të UV, Kreu VIII, neni 80, 81 dhe 82, në përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të sigurimit të brendshëm të cilësisë merren parasysh disa kritere të cilat lidhen me kompetencat profesionale, paanshmërinë, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të Komisionit.</p> <p>Anëtarët gjithashtu nuk duhet të jenë pjesë e autoriteteve drejtuese. Këto kritere garantojnë mosdiskriminimin dhe respektimin e integritetit akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Institucioni konsideron të rëndësishëm zgjerimin e bazës të aktorëve pjesëmarrës në vlerësimin e cilësisë. Organizimi i tryezës së diskutimit me operatorë të tregut të punës për të diskutuar mbi cilësinë e procesit akademik, nëpërmjet njohjes dhe vlerësimit të studentëve të UV, është tregues i përpjekjeve të institucionit për të ndërtuar sisteme efektive vlerësimi.</p>




	GVJ sugjeron që kjo praktikë e mirë, të shndërrohet në instrument të përhershëm vlerësimi.		
Shkalla e përbushjes së standardit			Vlerësimi kryesor
			✓

Standardi VI.5
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UV ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, duke përbushur kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Shqipëri si edhe kërkesat e përcaktuara në aktet rregullatore të brendshme institucionale si Statuti (Evidenca A), Rregullorja e Institucionit (Evidenca 2.5). Politikat dhe strategjia e UV është transparente, ndërsa rezultatet bëhen publike për të gjithë të interesuarit. GVJ gjykon që politika, strategjia, organizimi dhe të gjitha veprimtaritë në kuadrin e zhvillimit të sistemit të garantimit të Cilësisë, janë transparente, ndërsa studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të aksesojnë të dhënat dhe rezultatet.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në institucion funksionon Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, i cili zbaton një strategji institucionale. Institucioni ndërmerr inisiativa që kë synojnë vlerësimin dhe garantimin e cilësisë. Raportet që përmbajnë rezultatet e vlerësimeve janë publike (https://univlora.edu.al).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Analiza e rezultateve të vlerësimit është objekt i mbledhjes së departamentit, i cili propozon planin e masave, që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. <i>Megjithatë GVJ konstaton se të dhënat janë të pamjaftueshme për të gjykuar mbi shkallën e plotësisë të planit të masave të ndërmarra nga departamenti në vijim të arritjes së synimit thelbësor, përmirësimin të cilësisë.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Statuti (Evidenca A), Rregullorja e Institucionit (Evidenca 2.5), Evidencat K,L,N dëshmojnë se institucioni ka hartuar dokumenta dhe përcaktuar procedura, që synojnë në rritjen e efektivitetit dhe ndikimit në procesin e cilësisë, ndonëse GVJ konstaton se nuk ka të dhëna që dëshmojnë matjen e këtij efektiviteti.

<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësimin e institucionit, ka qenë dhe mbetet thelbësore për njësinë bazë, e cila është përpjekur me shumë mënyra që të ndërgjegjësojë studentët dhe grupe të tjera interesi për të marrë pjesë. GVJ gjykon që departamenti ka qenë i sukseshëm në përpjekjet e tij, derisa mëse 90% e studentëve marrin pjesë në vlerësim.</p> <p>Sidoqoftë, <i>GVJ thekson se komentet e nënvizuara më lart në lidhje me formalizimin dhe unifikimin e metodologjisë, grupeve pjesëmarrëse, instrumentave, madhësisë së mostrës dhe cilësive të saj, duhet të konsiderohen me përparësi për të garantuar proces vlerësimi rigorozisht shkencor dhe njëherazi, efektiv.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>			<p>Përmbushet kryesisht</p> <p>✓</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p>✓</p>		
---	--------------------------------------	--	--




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor
“Marketing” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Ismail Qemali “Vlorë”**

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Imazhi, reputacioni dhe emri i mirë i institucionit i mbështetur në eksperiencën, traditën, ofrimin e njohurive bashkëkohore, cilësore dhe në përputhje me standarte ndërkombëtare, cilësi që demonstron qartë nëpërmjet konsolidimit të programit të studimit në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e përcaktuara në “Strategjinë e zhvillimit të programit”.
2. Cilësia e lartë profesionale e stafit akademik.
3. Liria akademike dhe fleksibiliteti i tematikës si edhe i metodave të mësimdhënies, të mbështetura nga vëmëndja e vazhdueshme dhe kërkimi për të gjetur e zbatuar praktika të mira, më të përshtashme dhe efektive.
4. Mbështetja, këshillimi, bashkëpunimi dhe udhëheqja e studentëve përgjatë aktivitetit akademik në shkollë.
5. Mbështetja financiare e institucionit për nxitjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete kërkimore shkencore.
6. Përshtatshmëria dhe lehtësia e procedurave të transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, rrjedhojë e vëmëndjes së institucionit ndaj përmirësimit cilësor të programit dhe harmonizimit të tij me kërkesat e tregut.
7. Dixhitalizimi i procedurës së aplikimit dhe komunikimit të studentëve me institucionin, si për procesin akademik, edhe për procese administrative dhe operacionale, në sajë të platformës dixhitale UVMS.
8. Pozicionimi i UV në tregun e arsimit të lartë, si institucioni i vetëm publik në një territor të konsiderueshëm, sipas kriterit të sipërfaqes dhe popullsisë.
9. Lidhja me operatorët e tregut dhe institucionet e tjera publike dhe jo publike.

Pika të dobta:

1. Mungesa e një studimi të plotë dhe të thelluar tregu që të përfshijë jo vetëm Bashkinë Vlorë, por edhe bashkitë fqinje, të rinjtë e të cilave frekuentojnë Universitetin e Vlorës, lidhur me prirjet dhe ndryshimet e shpejta në profilin Marketing në mënyrë që institucioni të përforcojë evidencat dhe të dhënat mbi




- përparësitë e këtij programi në raport me programe të tjera Bachelor të ofruar në fushën e biznesit.
2. Mungesa e objektivave specifike dhe të qarta të programit të studimit Bachelor në Marketing.
 3. Ofrimi i lëndëve të ngjashme të formimit karakterizues, që cënon garantimin e dijeve dhe kompetencave aktuale te profilit.
 4. Mungesa e marrëveshjeve të bashkëpunimit me biznesin në funksion të rritjes së aftësive praktike të studentëve dhe arritjen e qëllimeve të programit të studimit.
 5. Angazhim i pamjaftueshëm i Zyrës së Karrierës dhe Njesisë përgjegjëse për të kontribuar në integrimin e praktikës mësimore të studentëve në planin mësimor të programit Bachelor në Marketing (siç qëndron në programe e tjera bachelor të njesisë) dhe organizimin e saj me punëdhënës të bizneseve lokale.
 6. Mungesa e praktikave mësimore si pjesë e programit akademik, ndërsa është edhe kërkesë e studentëve.
 7. Mungesa e informacionit mbi ecurinë e studentëve/alumni në tregun e punës si edhe ndërtimi i fushatës promovionale me synim nxitjen e prurjeve të reja dhe nxitjen e kërkesës së ardhshme për këtë program.
 8. Ngarkesa mësimore është tepër e lartë, e shprehur si në numrin mesatar të orëve në auditor, ashtu edhe në numrin e lëndëve, të zhvilluara nën përgjegjësinë e një lektori.
 9. Mungesa e të dhënave mbi rezultatet dhe ndikimin e eksperiencave bashkëpunuese me universitete të huaja në zhvillimin e programit dhe të stafit.
 10. Mungesa e kushteve fizike të institucionit dhe mungesa e ngrohjes, dhe pajisjeve didaktike dixhitale si kompjuter e projektor në auditore.
 11. Mungesa e literaturës bashkëkohore në bibliotekë dhe e aksesit në revistat shkencore online.
 12. Mospërdorimi i formave të vlerësimit në mënyrë elektronike (si p.sh nëpërmjet Clean Score, një nga format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve). Mungesa e sekretimit të provimeve përpara korrigjimit.
 13. Mungesa e një metodologjie të unifikuar vlerësimi të cilësisë, të miratuar në departament.

Rekomandime:

1. Njësia përgjegjëse e programit të ndërmarrë një studim të thelluar tregu lidhur me prirjet dhe ndryshimet e shpejta në profilin Marketing në mënyrë që të përforcojë avantazhet e këtij programi në raport me programe të tjera Bachelor të ofruar në fushën e biznesit.
2. Rishikimi i objektivave të programit të studimit Bachelor në Marketing, në drejtim të formulimit të objektivave specifike dhe të qarta.
3. Rishikim të lëndëve të formimit karakterizues duke shqyrtuar mundësinë e përfshirjes të lëndëve Marketing Dixhital, Komunikimi i integruar marketing, Inovacion. Gjithashtu, në vend të përsëritjes të lëndëve karakterizuese Strategji Marketing dhe Marketing Strategjik, të shikohet mundësia e integritit të njërës lëndë në Planifikim Marketing me aplikim praktik në biznese.
4. Rritja e bashkëpunimeve të institucionit me organizatat e biznesit dhe institucionalizimi i tyre me qëllim rritjen e mundësive të studentëve për veprimtari vullnetare, praktika mësimore apo punësim sezonal/afatshkurtër etj, në funksion të rritjes së aftësive praktike të studentëve dhe arritjen e qëllimeve të programit të studimit.
5. Orientimi i studentëve drejt aftësive praktike, aftësive në punë dhe zhvillimeve të tregut të punës nëpërmjet aktivizimit efektiv të Zyrës së karrierës dhe Njesisë përgjegjëse për të kontribuar në integrimin e praktikës mësimore të studentëve në planin mësimor të programit Bachelor në Marketing. Këtij qëllimi mund t'i shërbejë edhe shtimi i lëndëve si menaxhimi i karierrës për të përgatitur studentët në hapat drejt tregut të punës, dhe përtej kësaj, drejt kualifikimeve të mëtejshme në rrugën e karierrës.
6. Përfshirja e Praktikave Mësimore si pjesë e programit akademik.
7. Krijimi i bazës të të dhënave të studentëve ndër vite si edhe përdorimi i informacionit me transparencë. Baza e të dhënave të përfshijë informacione në lidhje me punësimet e studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi, mbi bazën e të cilës të ndërtohet fushata promovionale e institucionit me synim nxitjen e prurjeve të reja dhe të kërkesës së ardhshme për këtë program.
8. Rishikimi i ngarkesës mësimore, si në numrin mesatar të orëve në auditor, ashtu edhe në numrin e lëndëve, të zhvilluara nën përgjegjësinë e një lektori.




9. Analiza dhe vlerësimi i eksperiencave të bashkëpunimeve me institucione të huaja, identifikimi i praktikave të mira dhe organizimi programeve të përhapjes dhe zbatimit të këtyre praktikave.
10. Përmirësimi i kushteve fizike të institucionit dhe pajisja e auditoreve me ngrohje, dhe pajisje didaktike dixhitale si kompjuter e projektor. Gjithashtu, të shtohen laboratorët e kompjuterave për studentët pasi në nivel Fakulteti ofrohet vetëm një laborator me 25 poste. Mjediset në të cilat zhvillohet aktiviteti akademik kanë nevojë për përmirësim në mënyrë që aktiviteti akademik e shkencor të zhvillohet në standartin e nevojshëm.
11. Rinovimi i bibliotekës me titujt bashkëkohorë si dhe rinovimi i aksesit në revistat shkencore online. Më tej, dixhitalizimi i bibliotekës, përditësimi në titujt bashkëkohorë të literaturës të huaj e vendase dhe sigurimi i aksesit në biblioteka online për veprimtari kërkimore nga studentë e pedagogë.
12. Përdorimi i formave të vlerësimit në mënyrë elektronike (si p.sh nëpërmjet Clean Score, një nga format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimit të studentëve). Testimi e vlerësimi i dijeve me shkrim të zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim.
13. Unifikimi i metodologjisë së vlerësimit dhe përdorimi i tij efektiv, përmes vendosjes së standardeve dhe proceseve dhe miratimit të tyre në departament, si dhe ndërmarrjes së iniciativave që promovojnë zhvillimin dhe kualifikimin e stafit përballë zbatimit të procedurave të vlerësimit . Praktika e mirë e përfshirjes së diskutimeve si tryeza e rrumbullakët në "tregun e punës" për të vlerësuar cilësinë e programit mund të shndërrohet në një instrument të qëndrueshëm vlerësimi. Pjesëmarrja e Alumni, si dhe e grupeve të rëndësishme të interesit dhe aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në listën e intervistuesve sigurisht që do të përmirësojë cilësinë e vlerësimeve dhe rezultatet e tyre.




Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor "Marketing" of the Institution of Higher Education "Ismail Qemali" University, Vlora.

Strengths and affirmations:

1. The image, reputation and the good name of the institution based on experience, tradition, the provision of contemporary knowledge as well as the quality standards, which clearly are demonstrated through the consolidation of the study program in compliance with its mission and objectives as stated in the "Program Development Strategy".
2. High professional quality of academic staff.
3. Academic freedom, flexibility to choose a variety of themes as well as teaching methods, encouraged by continuous focus on research and development to identify and implement comprehensive, comparative and effective practices.
4. The assurance of support, advice, cooperation and guidance vis-à-vis students alongside the academic preparation in school.
5. The provision of financial support to promote academic staff participation in research initiatives and projects.
6. Appropriate and flexible student's transfer procedures and equivalence of academic attainments, as a result of the institutional attention to continuously improve the quality of program in compliance with market demand.
7. Digitalization of the application procedures and student's communication with the institution, regarding academic and administrative processes, alike, thanks to the digital platform UVMS.
8. Favorable position of UV in the High Education market, as the only public institution covering a major territory, considering the population and the surface.
9. Wide network, composed of market operators as well as other public and non-public organizations.

Weaknesses:

1. The lack of a comprehensive and comparative market research, covering Vlora Municipality and other municipalities of the region, to analyse the tendencies in the demand and the most relevant developments of the supply side vis-à-vis Marketing Profile, to lay the foundation for the institution to make evidence based policies that




regard the advantages of the “Bachelor in Marketing” versus other business oriented programs offered in the field.

2. The lack of specific and clear study objectives of the “Bachelor’s in marketing” program.
3. The delivery of similar core subjects which harm the provision of relevant knowledge and competences of the profile.
4. The lack of cooperation agreements with business organizations to pave the way for students’ internships and works to impact on their practical skills and accomplishment of study program’s objectives.
5. Insufficient engagement of career office and responsible Unit to contribute to harmonize the students’ learning practices with academic program of “bachelor’s in marketing), (as it stands in other study programs with local businesses).
6. The lack of work practices provided as a learning component of academic program, ignoring the students ‘request.
7. The lack of information on the students’ and alumni’s performance vis-à-vis job career in the market and based on that the establishment of Promotional Strategy to influence new entries.
8. Academic staff is overloaded, taking into consideration the average hours in auditor as well as the number of courses, managed by a lecturer.
9. The lack of data on the results and the impact of foreign experiences and cooperation on the program and staff development.
10. The inappropriate infrastructure due to the lack of heating as well as digital didactic materials like computers and projectors in auditors.
11. The lack of relevant and contemporary literature in the library as well as of the online access to scientific journals.
12. The un-use of electronic forms of students ‘evaluation (like through Clean Score) as one of the contemporary forms of students ‘control and evaluation. The lack of students’ secret coding during exams.
13. The lack of a unique quality evaluation methodology approved by the department.




Recommendations:

1. The unit in charge of the program should undertake a comprehensive and comparative market research, to analyze the tendencies in the demand and the most relevant developments of the supply side vis-à-vis Marketing Profile, to lay the foundation for the institution to make evidence based policies that regard the advantages of the “Bachelor in Marketing” versus other business oriented programs offered in the field.
2. The revision of current objectives of the “Bachelor’s in marketing” program and reformulation of specific and clear ones.
3. The revision of core subjects, discussing the opportunity to provide subjects like Digital Marketing, Integrated Communication in Marketing and Innovation. Alternatively, rather than the delivery of similar core subjects like “The Strategy of marketing” and “Strategic marketing”, the department may integrate one of them into Marketing Planning.
4. The extension of cooperation with business organizations and institutionalization of their relationships to pave the way for students’ internships and works to impact on their practical skills and accomplishment of study program’s objectives.
5. Career office and responsible Unit should actively contribute to guide students towards practical and labor skills to harmonize the students’ learning practices with academic program of “bachelor’s in marketing), (as it stands in other study programs with local businesses). The provision of subjects like “Career management “may be of value to facilitate the students’ transition to labor market and beyond that, to establish their career.
6. The inclusion of “Work Practices” as a teaching component of the academic program.
7. The establishment of alumni data base and the use of information in a transparent manner. The data base should contain information on the students’ and alumni’s performance vis-à-vis job career in the market, which can provide updated inputs to establish the Promotional Strategy to influence new entries.
8. The revision of workload, as a composite indicator of the average number of hours in auditor per lecturer and the number of courses per lecturer.
9. The analyses and evaluation of experiences and cooperation with foreign academic institutions, the identification of best practices, their share and implementation.

10. The improvement of infrastructure, namely the installment of heating and the provision of digital didactic materials like computers and projectors in auditors. In addition, the number of computers laboratories has to increase due to the extremely limited number of the existing one with only 25 work posts. In overall, academic infrastructure has to improve to guarantee the pertinent standard of learning processes.
11. The renewal of library's titles, including recent ones as well as the assurance of online access to scientific journals. Furthermore, the digitalization of the library, its update with contemporary publications of the Albanian and Foreign literature, as well as the assurance of the access to online libraries to support students' and lecturers' academic research.
12. The use of electronic forms of students 'evaluation (like through Clean Score) as one of the contemporary forms of students 'control and evaluation. The establishment and use of secret coding during exams.
13. The unification of evaluation methodology and its effective use, through the establishment of standards and processes and their approval in the department as well as the undertaking of initiatives that promote the staff development and qualification vis-à-vis the implementation of the evaluation procedures. The good practice of involvement of discussions like the round table on the "labor market" to evaluate the quality of the program may be transformed into a sustainable evaluation instrument. The participation of Alumni as well as of permanent internal and external key stakeholders in the list of interviewers will certainly improve the quality of evaluations and their outcomes.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			✓	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				✓
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			✓	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			✓	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			✓	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			✓	
VLERËSIMI TËRËSOR			✓	

